REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2434/ 8 prot Datë 17/11/2023

V E N D I M
Nr. 1189/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17/11/2023 me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. *REF-61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: Operatori ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK, me NIPT: L28029301Q, dhe me adresë: *Fshatin Gurez, afër ish-Kanalit të Acidit, Gurez, Fushë-Kuqe, Lezhë.*

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Adresa: Rruga e Kavajës Nr 1001 Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.03.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. *REF- 61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe duke publikuar ne Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. *Procesverbalin e hartimit të kritereve kualifikuese dhe të specifikimeve teknike në gjuhën shqipe me emërtimin "**Argumentim kriteresh Mbetjet 2023.docx**"*
2. *Dokumentat e tenderit në gjuhën shqipe me emërtimin "**Procedure_e_Hapur_Sherbime_Mbetjet 2023.doc**".*
3. *Dokumentat e tenderit në gjuhën angleze me emërtimin "**Procedure e Hapur Mbetjet 2023 DST Anglisht.docx**".*
4. *Procesverbalin e hartimit të kritereve kualifikuese dhe të specifikimeve teknike në gjuhën angleze me emërtimin "**Argumentim Kriteresh Mbetjet Anglisht.docx**"*
5. *Dokumentin e specifikimet teknuke dhe termat e referencës në gjuhën angleze me mërtimin "**Aneks 1 Anglisht.pdf**".*
6. *Dokumentin e specifikimet teknuke dhe termat e referencës në gjuhën shqipe me mërtimin "**Aneks 1 Shqip.pdf**".*

II.2. Në datën 20.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 588 prot., e operatorit ekonomik "*Eco Empire*" SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si më poshtë vijon:

"*... lidhur me kapacitetin minimal për secilin prej impianteve sqarojmë se referuar argumentimit të autoritetit kontraktor, në referim të sasive ditore të përllogaritura për tu trajtuar dhe asgjësuar dhe sasive në kg/orë për tu trajtuar dhe asgjësuar arrihet në konkluzionin se këto përllogaritje janë nxjerrë duke marrë në konsideratë faktin se impiantet duhet të punojnë vetëm 16 orë në ditë. a) Referuar impiantit të trajtimit sasia ditore është 1799 kg dhe përllogaritja e sasisë së përpunimit është 112 kg/orë. 1799/112 = 16. b) Referuar impiantit të përpunimit sasia ditore është 173 kg dhe përllogaritja e sasisë së asgjësimit është 11 kg/orë. 173/11 = l5.7. Pra lehtësisht kuptohet se koha ditore e vënies në punë të impianteve është përllogaritur 16 orë pa asnjë argumentim ligjor apo qoftë dhe teknik se pse nuk përllogaritet për 24 orë. Kjo trengon qartazi se perllogaritjen e autoritetit kontraktor përsa më poshtë do të sqarojmë kanë për qëllim kufizimin e konkurrencës duke krijuar pengesave artificiale për OE të mundshëm pjesëmarrës dhe favorizimin e një subjekti i cili për sa më poshtë sqarojmë i disponon këto pajisje si në sasi dhe në kapacitet. Për rrjedhojë lidhur me përllogaritjen e impiantit të trajtimit dhe impiantit të asgjësimit të përllogariten kapacitetet minimale të tyre duke marrë në referim punimin e tyre për 24 orë në ditë. Në hartimin e kritereve autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt siç është rasti konkret. Çmojmë se kërkesa duke kufizuar numrin e impianteve me kapacitet minimal është diskriminuese, pasi një OE mund të disponoj disa impiante të cilat së bashku plotësojnë kapacitetin minimal të autoritetit kontraktor për sa i përket trajtimit dhe asgjësimit në kg/orë. Autoriteti kontraktor kërkon që OE pjesëmarrës të ketë në pronësi ose me qira këto impiante e për më tepër jo vetëm impiantin kryesor por dhe atë backup është diskrimues dhe nuk është në përputhje me dispozitat ligjore. Në referim të argumentimit të dhënë nga autoritetit kontraktor edhe ne çmojmë se është minimalisht për impiantet kryesore ato mund të kërkohen në pronësi apo me qera por për impiantet back up ato mund të plotësohen edhe nëpërmjet mënyra të tjera që ligji njeh si janë kontratat e porosisë etj. Autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizohet vetëm në kërkesën për pajisjet (në rastin konkret impiantet) me qira ose në pronësi, në kushtet kur disponueshmëria e tyre mund të vërtetohet edhe me forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke mos krijuar barriera e pengesa në lidhje me*

kriterin për impiantet (e sidomos ato back up), por duke krijuar lehtësi për konkurrencë të hapur për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar te cilët kanë disponueshmërinë e mjeteve në një prej formave që njeh legjislacioni në fuqi. Në rastin konkret, kur kemi të bëjmë me një kontratë disavjeçare dhe konkretisht referuar kohëzgjatjes së kontratës kemi të bëjmë me një shërbim 3-vjeçar të shtrirë në kohë, me qëllim mospenalizimin e tyre, si edhe në kuadër të mosdiskriminimit dhe krijimit të lehtësirave për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit duke përcaktuar disponueshmërinë e mjeteve me të gjitha format e njohura nga legjislacioni përkatës në fuqi si edhe të bëjë formulimin e tij pa shkaktuar konfuzion, si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit të ofertës së tyre, ashtu edhe tek autoriteti kontraktor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të 5 ofertave. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomik pjesëmarrës të provojnë se disponojnë kapacitetet teknike (makineri, pajisje ej) në një nga mënyrat e përcaktuara nga legjislacioni përkatës, gjithçka në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës. Gjithashtu çmojmë se e njëjta logjikë duhet ndjekur edhe për kërkimin për disponimin me qira ose në pronësi dhe të mjeteve për larjen e kontejnerëve të cilët mund të plotësohen nga OE pjesëmarrës si nëpërmjet kontratës së porosisë, kontratës së shitjes me kusht etj. Çmojmë se kërkesa e autoritetit kontratkor për disponimin jo vetëm të impianteve të cilët do të bëjnë trajtimin dhe asgjësimin, duke vendosur dhe kufirin minimal të kapacitetit të tyre por dhe të disponimit dhe të impiantëve back up është diskriminuese dhe e pabazuar në ligj. Në rastin konkret kërkimi për disponimin jo vetëm të impiantëve të cilat do të kryejnë trajtimin dhe asgjesimin por dhe atyre back up nuk është i bazuar ligjërisht, nuk është në proporcion dhe në përputhje me objektin e kontratës por vetëm për faktin se këto impiante disponohen vetëm nga një OE e konkretisht ECO RICIKLIM ShPK. Për sa më sipër, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri referuar kundërshtimeve dhe shpjegimeve të dhëna më sipër.".

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 588/2 prot., datë 27.03.2023 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikim teknik, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*Eco Empire*" SHPK.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 543/10 prot., datë 29.03.2023 protokolluar me tonën me nr. 588/3 prot., datë 30.03.2023 me objekt "*Dërgohet Informacion*", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion dhe vendimi i autoritetit kontraktor nr 543/9 prot, datë 29.03.2023 lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*Eco Empire*"

SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku konstatohet se ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 443/2023, datë 30.05.2023, ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Eco Empire" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Eco Empire" SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Me shkresën nr. 543/13 prot., datë 06.07.2023, protokolluar me tonën nr. 588/6 prot., datë 07.07.2023, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informon se ka përgatitur modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit në përputhje me vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar",* me Nr. *REF- 61901-03-09-2023,* me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 **(***shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë***)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni vërejti se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik shtojcën e modifikuar nga verifikimi i së cilës u konstatua se ky i fundit nuk kishte kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet dhe interpretimet e vendimit Nr. 443/2023, datë 30.05.2023.

II.8. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 543/13 prot., datë 06.07.2023, protokolluar me tonën nr. 588/6 prot., datë 07.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 668/2023, datë 25/07/2023, ka vendosur:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë**)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht Vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Me shkresën nr. 543/16 prot., datë 15.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/8 prot., datë 16.08.2023, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informoi se ka zbatuar vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar",* me Nr. *REF- 61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 **(***shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë***)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vërejti se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar kkishte dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik shtojcën e modifikuar nga verifikimi i së cilës konstatohet se ky i fundit kishte kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet dhe interpretimet e vendimit Nr. 443/2023, datë 30.05.2023. Por nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik KPP konstatoi se autoriteti kontraktor <u>nuk e kishte publikuar shtojcën e modifikuar në sistemin e prokurimeve elektronike</u>. Ndaj në këto kushte, KPP i la detyrë autoritetit kontraktor të merrte masa për publikimin e shtojcës përkatëse në përputhje me konstatimet e vendimit nr. 443/2023, datë 30.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 543/16 prot., datë 15.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/8 prot.,

datë 16.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 793/2023, datë 22/08/2023, ka vendosur:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Autoriteti kontraktor të marrë masa dhe të publikojë shtojcën e modifikuar të dokumentave të tenderit në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me përcaktimet e Vendimit Nr. 443/2023, datë 30.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.11. Në datë 28.08.2023, në zbatim të vendimit nr. 443/2023, datë 30.05.2023 dhe vendimint nr. 793/2023, datë 22/08/2023, të Komisioit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor kishte modifikuar dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. *REF-61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit shtojcën përkatëse me emërtimin "***V.3...Shtojce modifikimi mbetjet 2023... sipas vendimit te KPP-se.docx***" dhe përmbajtjen, si më poshtë:

[...]
Shtojca 1

Lënda: "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH.

1. Njoftohen të gjithë OE e interesuar se në pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 të Shtojcën 8, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të DST së sipërcituar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

ISHTE:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.1. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,

1.2. Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,

1.3. Makineri për larjen e kontenierëve dhe një makineri back up të tillë (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem) - cope 2.

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineria për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te riperdorshem duhet të jenë të pajisur me;

a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie;

c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*

**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

BËHET:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.4 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me të njëjtën metodë back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/ore në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet),

1.5 Impiant/e për asgjësimin me incenerim dhe impiant/e incenerimi back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 11 kg/ore në total ose 176 kg/ditë, në të dyja rastet),

1.6 Makineri për larjen e kontenierëve dhe makineri back up të tillë (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 2

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me;

d) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

e) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.

f) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*

**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*

Shënim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

ISHTE:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise,
• Minimalisht 2 (dy) Dokumenta të Transferimit të Mbetjeve të plotësuara nga ofertuesi me subjektin gjatë 3 muajve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës ku të jetë pasqyruar depozitimi i sejcilit produkt që del nga trajtimi/asgjesimi (kod 19 01 dhe kod 19 03) sipas VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".
"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

BËHET:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise.

**<u>Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues</u>.*

Të gjitha të dhënat e tjera mbeten të pandryshueshme. [...]

II.12. Me shkresën nr. 543/18 prot., datë 29.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/10 prot datë 31.08.2023, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar",* me Nr. *REF- 61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 **(***shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë***)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor sqaron se më datë 28.08.2023 ka publikuar në Sistemin e Prokurimieve Elektronike SPE shtojcën e modifikimit të dokumentave të tenderit, Komisionit Prokurimit Publik pasi kreu verifikimet në Sistemin e Prokurimve Elektronike konstatoi se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën e modifikuar në SPE me emërtimin "***V.3...Shtojce modifikimi mbetjet 2023... sipas vendimit te KPP-se.docx***" në përputhje me konstatimet e lënë në vendimet Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, Nr. 668/2023, datë 25.07.2023, Nr. 793/2023, datë 22.08.2023.

II.13. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 543/18 prot., datë 29.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/10 prot., datë 31.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 856/2023, datë 04/09/2023, ka vendosur:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF- 61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë**)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elktronike si auditues Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se më datë 25.09.2023, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistem për këtë procedure prokurimi dokumentin e emërtuar "***543.21 (1).pdf***", por që nuk

është publikuar në këtë sistem për tu njohur jo vetëm të gjithë operatorët ekonomik ofertues të mundshëm, por edhe Komisioni i Prokurimit Publik.

II.15. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elktronike si auditues Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se më datë 29.09.2023, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistem për këtë procedure prokurimi dokumentin e emërtuar "***Shtojce modifikimi mbetjet 2023 me miratim KPP vs. eng.docx***", por që nuk është publikuar në këtë sistem për tu njohur jo vetëm të gjithë operatorët ekonomik ofertues të mundshëm, por edhe Komisioni i Prokurimit Publik.

II.16. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 04.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2434 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3466 e operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, si më poshtë vijon:

[...]
3. Rrethanat dhe faktet
përshkruani rrethanat e faktit.

Rezulton se në SPE është publikuar procedura e prokurimit publik me objekt "shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore", me ak ministria e shendetesise dhe mbrojtjes sociale.
Fillimisht kjo procedurë prokurimi është pezulluar pas një ankimi administrativ të kryer pranë komisionit të prokurimit publik nga një subjekt i tretë palë e interesuar për këtë procedurë prokurimi.
Pas vendimarrjes së komisionit të prokurimit publik, AK, me datë 25.09.2023 ka ngarkuar në SPE shtojcën e re të ndryshimeve të kritereve të tenderit.
Brenda afatit ligjor (10 ditë nga dita e publikimit të shojcës në SPE) paraqesim këtë ankesë pranë AK-së dhe KPP-së përsa më poshtë vijon.

Fillimisht nga AK në DST është kërkuar:
2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.1 Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,
1.2 Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,

Më pas, ky kriter është ndryshuar si më poshtë:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.1 Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,

1.2 Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,

Në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është ngarkuar dhe dokumenti i emërtuar "Argumenti i Kritereve Mbetjet 2023" autoriteti kontraktor citon se;

"Për të përllogaritur kapacitetet minimale të kërkuara, për secilin impiant, është marrë për bazë sasia totale e parashikuar për gjithë periudhën, e përllogaritur në sasi mesatare ditore duke prezumuar punë të pandërprerë të impianteve për 365 ditë në vit dhe më tej është përllogaritur kapaciteti orar, duke prezumuar impiantet në gjendje pune për 16 ore (dy turne).

Grupet sipas metodës së trajtimit Sasi 36 muaj në kg Sasi 12 muaj në kg Sasi ditore në kg Sasi në kg/ore

Asgjesim me incenerim (18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe); 18 01 06; 18 01 07; 18 01 08; 18 01 09) 190,177.00 63,392.00 173.00 11.00

Trajtim me metoda të ndryshme nga incenerimi (18 01 01; 18 01 02 (përveç pjesë të trupit dhe organe); 18 01 03; 18 01 04) 1,970,115.00 656,705.00 1,799.00 112.00

Duke mbajtur në konsideratë, se impiantet do jenë në gjendje pune të vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohet edhe një makineri back up, për secilin impiant me të njëjtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licensat përkatëse, çka sërish do të shkaktonte ndërprerje me muaj të shërbimit.

Lejet e kërkuara për objektin/et e dhënë/a me qera vërtetojnë se këto pajisje janë të licensuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky ceritfikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e tretë ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë.

Fokusi i kësaj kërkese është tek impianti dhe jo tek personat e tretë të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Duke qënë një procedurë e përqëndruar me kërkesa nga të gjitha spitalet publike, ky shërbim do të jetë i vazhdueshëm dhe me dinamika të ndryshme në rang territori kombëtar. Kërkesat për marrjen e mbetjeve ditore nuk mund të përcaktohen paraprakisht pasi dhe vetë spitalet nuk mund të parashikojnë gjenerimet në bazë ditore çka do të bënte një calendar të saktë për OE. Afatet kohore për grumbullimin e mbetjeve janë taksative nga pikëpamja ligjore dhe të

ndryshme sa i takon rrymave të tyre. Rrjedhimisht kjo gjë kërkon me patjetër nga OE grumbullimin e mbetjeve sipas kërkesave të AK-ve në kohë të ndryshme çka e ben këtë shërbim të vazhdueshëm dhe të paparashikueshëm. Një system reserve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të forcës madhore (mbi ngarkesë në sasitë) etj.
Sqarojmë se studimi i tregut dhe i gjithë dokumentacioni vijues është kryer nga autorieti kontraktor, vetëm me 1 qëllim, pengimin e konkurencës dhe paracaktimin e subjektit fitues, i cili është shoqëria "ECO Riciklim" shpk. Siç do të provojmë më poshtë, tashmë fituesi i kësaj procedure prokurimi është paracaktuar dhe zhvillimi i procedurës së hapur është thjesht fiktiv.

...

Me veprimet e tij, autoriteti kontraktor, me zhvillimin e kësaj procedure prokurimi me këtë kriter të vendosur ka cënuar çdo parim dhe qëllim të vendosur nga ligjvënësi. pse e themi këtë?!

Së pari, në fushën objekt prokurimi rezultojnë të operojnë vetëm 4 kompani, e konkretisht:
1. V.A.L.E Recycling shpk
2.Medi Tel shpk
3. Pura-Medical shpk
4. Eco Riciklim shpk

Çuditërisht, vetëm shoqëria Eco Riciklim shpk (shoqëria e paracaktuar fituese), referuar dhe dokumentacionit shoqërues të ankesës rezulton të ketë kapacitetin e kërkuar nga ak si më sipër, ndërsa të tre subjektet juridik të marrë së bashku nuk e arrijnë dot kufirin minimal të vendosur nga ana e autorietit kontraktor per kapacitetin e autoklaves.
Për çudi, rezulton se kjo shoqëri është licensuar vetëm 3 muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe pikërisht me të njëjtin kapacitet të vendosur si kriter nga ak në dst. ajo që e bën më dyshuese faktin është se pavarsisht se kjo shoqëri është licensuar në muajin dhjetor 2022, instalimin dhe inagurimin e impiantëve e ka kryer vetëm 10 ditë para publikimit të zhvillimit të procedurës Shiko linkun (https://www.ecosteryl.com/un-site-magnifique-pour-traiter-les-dechets-medicaux-en-lbanie/)
Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit e konkretisht të shoqërisë se lartpermendur, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensën në procedurat e prokurimit pubik.
Në këtë rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin, thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurencën dhe lehtësimin e procecudrës për shpalljes fitues të subjektit ECO RICIKLIM.
Së dyti, nuk kemi një sigurim të fondeve publike pasi a) vetëm një operator ekonnomik do të jetë në treg i cili do të paracaktojë dhe cmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurencën, zhvillimi dhe përcaktimi i cmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirësigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga një operator ekonomik.

Së treti, me veprimet e tij, autoretit kontraktor jo vetëm nuk po nxit pjesmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërisë se paracaktuar prej tyre.

Së kartërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkuencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg.

Në analizë të dispozitave ligjore të LPP-së, sqarojmë se, autoriteti kontraktor gjatë përcaktimit të kritereve të veçanta duhet të shmangi çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, e cila përbën diskriminim ndaj një ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. por në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese (aëard criteria), për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre.

Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

AK është i detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e LPP-së në hartimin e kritereve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë të hapur dhe gjithëpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.
Synimi bazë i autoritetit kontraktor është realizimi i kontratës objekt prokurimi (përfitimi) i punimeve referuar standardeve të caktuara. Në lidhje me mekanizimin për realizimin e synimit të vendosur nga autoriteti kontraktor, gjykojmë se nuk gjendet në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.
Kriteret teknike të vendosura nëpërmjet specifikimeve teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustifikuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.
Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Njësia e prokurimit etj me dashje dhe me anë të veprime/mosveprimeve konkrete kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrat e ngarkuara nga ligji. pra veprimet e tyre janë

tërësisht abuzive nga ajo se cfarë duhet të bënin në fakt këto komisione. e drejta e garantuar me ligj nuk është përdorur në këtë rast në mënyrën e duhur në interes të ligjit dhe të së mirës shoqërore por me veprimet e tyre kanë vepruar kundër saj. asnjë prej veprimeve apo mosveprimeve të tyre nuk përligjen dhe nuk burojnë nga e drejta e përcaktuara nga dispozitat ligjore të sipërcituara por janë rezultat i interesave të ngushta vetjake dhe me efekt të kundërt ndaj të mirës shoqërore.

Sa më sipër, përfundimisht kërojmë nga autoriteti kontraktor dhe kpp anullimin e proceudrës së prokurimit. [...]

II.17. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.18. Më datë 11.10.2023 është dërguar në sistemin elektronik të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK dhe protokolluar me tonën me nr. 2434/2 prot, datë 11.10.2023, duke informuar si më poshtë vijon:

Lënda: Vendim i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit lidhur me ankesën e OE "V.A.L.E RECYCLING" shpk, lidhur me dokumentacionin procedurës së prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore".

Në përgjigje të ankesës se OE "V.A.L.E RECYCLING" shpk, datë 04.10.2023 konfirmuar në databazën e publikuar nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), sqarojmë si më poshtë:

1.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 110 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"

1.2. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, në këto kushte Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit me pezullimin e procedurës u investua për të marrë në shqyrtim objektin e ankesës se operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes

Il.1 Në datë 07.09.2023 Ministria e Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore", prokurim - e hapur mbi kufirin e lartë monetar - shërbime.

11.2 Në datën 25.09.2023 në SPE është publikuar shtojca e ndryshimeve për "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhe 36 mujore" me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetë dhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëëind e tridhjet e tetë) Leke pa TVSH.

11.3 Në datën 04.10.2023 OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k. ka paraqitur ankesë, konfirmuar kjo në databazën e publikuar nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), lidhur me dokumentat e tenderit.

Konkretisht ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Rezulton se në SPE është publikuar procedura e prokurimit publik me objekt "shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore", me ak ministria e shendetesise dhe mbrojtjes sociale.
Fillimisht kjo procedurë prokurimi është pezulluar pas një ankimi administrativ të kryer pranë komisionit të prokurimit publik nga një subjekt i tretë palë e interesuar për këtë procedurë prokurimi.
Pas vendimarrjes së komisionit të prokurimit publik, AK, me datë 25.09.2023 ka ngarkuar në SPE shtojcën e re të ndryshimeve të kritereve të tenderit.
Brenda afatit ligjor (10 ditë nga dita e publikimit të shojcës në SPE) paraqesim këtë ankesë pranë AK-së dhe KPP-së përsa më poshtë vijon.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara
Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmërinë në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Fillimisht nga AK në DST është kërkuar:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.1 Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,
1.2 Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,

Më pas, ky kriter është ndryshuar si më poshtë:
<u>2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve</u>

spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.1 Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,
1.2 Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,

Në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është ngarkuar dhe dokumenti i emërtuar "Argumenti i Kritereve Mbetjet 2023" autoriteti kontraktor citon se;
"Për të përllogaritur kapacitetet minimale të kërkuara, për secilin impiant, është marrë për bazë sasia totale e parashikuar për gjithë periudhën, e përllogaritur në sasi mesatare ditore duke prezumuar punë të pandërprerë të impianteve për 365 ditë në vit dhe më tej është përllogaritur kapaciteti orar, duke prezumuar impiantet në gjendje pune për 16 ore (dy turne).
Grupet sipas metodës së trajtimit Sasi 36 muaj në kg Sasi 12 muaj në kg Sasi ditore në kg Sasi në kg/ore
Asgjesim me incenerim (18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe); 18 01 06; 18 01 07; 18 01 08; 18 01 09) 190,177.00 63,392.00 173.00 11.00
Trajtim me metoda të ndryshme nga incenerimi (18 01 01; 18 01 02 (përveç pjesë të trupit dhe organe); 18 01 03; 18 01 04) 1,970,115.00 656,705.00 1,799.00 112.00
Duke mbajtur në konsideratë, se impiantet do jenë në gjendje pune të vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohet edhe një makineri back up, për secilin impiant me të njëjtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licensat përkatëse, çka sërish do të shkaktonte ndërprerje me muaj të shërbimit.
Lejet e kërkuara për objektin/et e dhënë/a me qera vërtetojnë se këto pajisje janë të licensuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky ceritfikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e tretë ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë.
Fokusi i kësaj kërkese është tek impianti dhe jo tek personat e tretë të cilët japin me qera apo huapërdorje.
Duke qënë një procedurë e përqëndruar me kërkesa nga të gjitha spitalet publike, ky shërbim do të jetë i vazhdueshëm dhe me dinamika të ndryshme në rang territori kombëtar. Kërkesat për marrjen e mbetjeve ditore nuk mund të përcaktohen paraprakisht pasi dhe vetë spitalet nuk mund të parashikojnë gjenerimet në bazë ditore çka do të bënte një calendar të saktë për OE. Afatet kohore për grumbullimin e mbetjeve janë taksative nga pikëpamja ligjore dhe të ndryshme sa i takon rrymave të tyre. Rrjedhimisht kjo gjë kërkon me patjetër nga OE grumbullimin e mbetjeve sipas kërkesave të AK-ve në kohë të ndryshme çka e ben këtë shërbim të vazhdueshëm dhe të paparashikueshëm. Një system reserve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të forcës madhore (mbi ngarkesë në sasitë) etj.

Sqarojmë se studimi i tregut dhe i gjithë dokumentacioni vijues është kryer nga autorieti kontraktor, vetëm me 1 qëllim, pengimin e konkurencës dhe paracaktimin e subjektit fitues, i cili është shoqëria "ECO Riciklim" shpk. Siç do të provojmë më poshtë, tashmë fituesi i kësaj procedure prokurimi është paracaktuar dhe zhvillimi i procedurës së hapur është thjesht fiktiv.

...

Me veprimet e tij, autoriteti kontraktor, me zhvillimin e kësaj procedure prokurimi me këtë kriter të vendosur ka cënuar çdo parim dhe qëllim të vendosur nga ligjvënësi. pse e themi këtë?!

Së pari, në fushën objekt prokurimi rezultojnë të operojnë vetëm 4 kompani, e konkretisht:
1. V.A.L.E Recycling shpk
2.Medi Tel shpk
3. Pura-Medical shpk
4. Eco Riciklim shpk

Çuditërisht, vetëm shoqëria Eco Riciklim shpk (shoqëria e paracaktuar fituese), referuar dhe dokumentacionit shoqërues të ankesës rezulton të ketë kapacitetin e kërkuar nga ak si më sipër, ndërsa të tre subjektet juridik të marrë së bashku nuk e arrijnë dot kufirin minimal të vendosur nga ana e autorietit kontraktor per kapacitetin e autoklaves.
Për çudi, rezulton se kjo shoqëri është licensuar vetëm 3 muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe pikërisht me të njëjtin kapacitet të vendosur si kriter nga ak në dst. ajo që e bën më dyshuese faktin është se pavarsisht se kjo shoqëri është licensuar në muajin dhjetor 2022, instalimin dhe inagurimin e impiantëve e ka kryer vetëm 10 ditë para publikimit të zhvillimit të procedurës Shiko linkun (https://ëëë.ecosteryl.com/un-site-magnifique-pour-traiter-les-dechets-medicaux-en-lbanie/)
Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit e konkretisht të shoqërisë se lartpermendur, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensën në procedurat e prokurimit pubik.
Në këtë rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin, thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurencën dhe lehtësimin e procecudrës për shpalljes fitues të subjektit ECO RICIKLIM.
Së dyti, nuk kemi një sigurim të fondeve publike pasi a) vetëm një operator ekonnomik do të jetë në treg i cili do të paracaktojë dhe cmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurencën, zhvillimi dhe përcaktimi i cmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirësigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga një operator ekonomik.

Së treti, me veprimet e tij, autoretit kontraktor jo vetëm nuk po nxit pjesmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërisë se paracaktuar prej tyre.

Së kartërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkuencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg.

Në analizë të dispozitave ligjore të LPP-së, sqarojmë se, autoriteti kontraktor gjatë përcaktimit të kritereve të veçanta duhet të shmangi çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, e cila përbën diskriminim ndaj një ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. por në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese (aëard criteria), për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre.

Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

AK është i detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e LPP-së në hartimin e kritereve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë të hapur dhe gjithëpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.
Synimi bazë i autoritetit kontraktor është realizimi i kontratës objekt prokurimi (përfitimi) i punimeve referuar standardeve të caktuara. Në lidhje me mekanizimin për realizimin e synimit të vendosur nga autoriteti kontraktor, gjykojmë se nuk gjendet në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.
Kriteret teknike të vendosura nëpërmjet specifikimeve teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustifikuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.
Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

...

Njësia e prokurimit etj me dashje dhe me anë të veprime/mosveprimeve konkrete kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrat e ngarkuara nga ligji. pra veprimet e tyre janë tërësisht abuzive nga ajo se cfarë duhet të bënin në fakt këto komisione. e drejta e garantuar me ligj nuk është përdorur në këtë rast në mënyrën e duhur në interes të ligjit dhe të së mirës shoqërore por me veprimet e tyre kanë vepruar kundër saj. asnjë prej veprimeve apo mosveprimeve të tyre nuk përligjen dhe nuk burojnë nga e drejta e përcaktuara nga dispozitat

ligjore të sipërcituara por janë rezultat i interesave të ngushta vetjake dhe me efekt të kundërt ndaj të mirës shoqërore.

Sa më sipër, përfundimisht kërojmë nga autoriteti kontraktor dhe kpp anullimin e proceudrës së prokurimit.

III. Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

Arsyeton:

OE "V.A.LE. RECYCLING" shpk, në mënyrë të përmbledhur pretendon për mosplotësim të kritereve nga ky operator dhe disa të tjere.

Në këtë rast Operatori Ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. shprehet për kapacitetet teknike të operatorëve ekonomik si më poshtë:

V.A.L.E recycling shpk
Medi - Tel shpk
Pura-Medical shpk
ECO RICIKLIM shpk
Se të tre subjektet juridik të marrë së bashku nuk e arrinë dot kufirin minimal të vendosur nga ana e autorietit kontraktor për kapacitetin e autoklavës.

KSHA, ka shayrtuar Dokumentat Standarde të Tenderit dhe shprehet:

Bazuar në VKM, KREU XII, ANKIMI ADMINISTRATIV, Neni 94, Paraqitja e ankesave pika 1: "1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cila pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.".

KSHA ngritur me Urdhërin Nr. 627 prot, datë 05.10.2023 (Nr. 543/22 Prot., datë 05.10.2023) duke pasur parasysh zbatimin me rigorozitet të ligjit Nr. 162/2020 "PËR PROKURIMIN PUBLIK" dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", verifikoi pretendimet e ngritura nga ky operator, si dhe shtojcën e publikuar ne APP "V.3...Shtojce modifikimi mbetiet 2023 sipas vendimit te KPP-se.docx", ku për këtë kriter janë bërë ndryshimet si më poshtë:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të giitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.1 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me të njëjtën metode back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/orë në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet),
1.2 Impiant/e për asgjesimin me incenerim dhe impiant/e incenerimi back up (impianti/et duhel të përmbushin kapacitetin minimal 11 kg/orë në total ose 176 kg/ditë, ne të dyja rastet),
1.3 Makineri për larjen e kontenierëve dhe makineri back up të tillë (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshëm)-- minimalisht copë 2.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjesimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm duhet të jenë të pajisur me;

a. 1. Leje Mjedisore të tipit A (I11. 1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim a.2. Leje Miedisore të tipit A (III. 1.C) ose të tipit B (III. I.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente) ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
Katalog ose skedë teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e me sipërme.
Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

Në vijim KSHA shprehet:

Sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT".

Ky ligi percakton: Neni 23 "Menaxhimi i informacionit, pika I: "1. Të gjitha informacionet, lidhur me instalimet e kategorive A dhe B, bëhen publike dhe janë pjesë e sistemit të informacionit mjedisor, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"

Në këto të dhëna merret dhe informacioni për kapacitetet që këto subjekte të licensuara zotërojnë.

KSHA kërkoi në sistemin elektronik Qendrës Kombëtare të Biznesit https://gkb.gov.al/kerko/kerko-ne-registrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/) për subjektet e cituara nga ankimuesi si dhe vetë ankimuesin, të cilat kanë si objekt trajtimin e mbetjeve dhe që janë licensuar me licensat e lejimit të ushtrimit të aktivitetit me Leje Mjedisore të tipit A, në mënyrë që të verifikonte kapacitetet e impjanteve, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. MEDI-TEL SHPK me NIPT: J71519004Ë
Leja datë 27.06.2016, numër 2193, pika 2.2 përcaktohet: "Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, incenerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incenerimi. Sipërfaqja e sheshit ku zhvillohet veprimtaria është 4200 m^2. Kapaciteti i projektuar është më shumë se 1 ton/orë.

2. PURA-MEDICAL SHPK me NIPT: L71515507M
Leja datë 17.07.2023, numër 2909/3, pika 2.2 përcaktohet: ID 5.1/ Incenerimi imbetjeve të rrezikshme në në instalim incenerimi. ID 5.1 c Incenerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjeve e kafshēve në një instalim incenerimi përveç atij të referuar në pikën 5.1 a. ID 5.3/a Asgjesimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose landfilldim (5.2 a).
Sipërfaqja totale ku zhvillohet aktiviteti 852 m^2, me sipërfaqe truall 740 m^2, nga e cila 148 m^2 sipërfaqe ndërtese. Kapaciteti i projektuar i autoklavës është 1000 kg/cikël dhe kapaciteti i inceneratorit është 30 kg/cikël.

3. ECO RICIKLIM me NIPT: L61814009B
Leja datë 09. 11.2022, numër 2988/2, pika 2.2 përcaktohet: ID 5.1/a Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. ID 5.1 c Incenerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjeve e kafshēve në një instalim incenerimi përveç atij të referuar në pikën 5.1 a. ID 5.3/a Asgjesimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose landfilldim (5.2 a).
ID 12.1/b Incenerim i mbetjeve patologjike. Kapaciteti i projektuar për inceneratorët:
Kapaciteti për incenerim P25 MI është 100 kg/orë. Kapaciteti i projektuar për strerilizim/asgjesim: Kapaciteti i sterilizimit ECOSTERYL është 250-300 kg/orë (2-7 ton/ditë). Kapaciteti i sterilizimit më afër të NeëSter 50 është 90-110 kg/orë (janë 2 copë) 180-220 kg/orë. Sterilizuesi Neëster të mbetjeve spitalore infektive do të punojnë 24h pra, kapaciteti i mbetjeve spitalore do të jetë 4320-5280 kg/24 orë...

4. V.A.L.E. RECYCLING me NIPT: L28029301Q
Leja datë 22.04.2022, numër 2929/2, pika 2.2 përcaktohet se ID 5.1/ Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. ID 12.1/b Incenerim i mbetjeve patologjike. Sipërfaqja e objektit ku zhvillohet veprimtaria është 355.87 m^2. Kapaciteti i projektuar për një impiant incenerimi është 30-50 kg/cikël, ndërsa për funksionimin njëkohësisht të dy impianteve të incenerimit është 60-100 kg/cikël.

KSHA në zbatim të parimit themelor të ligjit të prokurimit publik, pas verifikimit të pretendimeve të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k.,

Vendos:

1. <u>Të pranojë pjesërisht ankesên e paraqitur nga OE "V.A.LE. RECYCLING" shpk</u>, për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuader me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Leke pa TVSH. Fondi limit/vlera e pritshme e

kontratave i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023: 6,868,777 Euro pa TVSH. REF-61901-03-09-2023 Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – shërbime - prokurim me mjete elektronike, me arsyetimin e lartëpërmendur.

2. Të rekomandojë rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Liglit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;

3. Ky vendim i komunikohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Komisionit të Prokurimit Publik dhe OE "V.A.LE. RECYCLING" shpk, (edhe në adresën e email - recycling.vale@gmail.com) nga personat përgjegjës për prokurimin në zbatim të pikave 2, 3 dhe 4, të urdhërit nr. 627, datë 05.10.2023.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin. [...]

II.19. Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK, duke informuar si më poshtë vijon:

[...]

Në zbatim të pikës 4 të nenit 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12.2020 "Për prokurimin publik", AK Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale në përfundim të shqyrtimit të ankesës së ardhur nga OE "V.A.L.E RECYCLING» Sh.p.k., për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit 785,788, 138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatēqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e teë2) Leke pa TVSH, REF-61901-03-09-2023, ju informojmë sa më poshë vijon:

Në datë 10.03.2023 në sistemin elektronik të prokurimeve është publikuar procedura e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhe 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të githa kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pese milion e shtatëqind e tetëdhjete e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Leke pa TVSH. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023: 6,868,777 Euro pa TVSH, REF-61901-03-09-2023, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - shërbime.

Më datën 25.09.2023 është publikuar në SPE Shtojca për Njoftim për Ndryshimin e Dokumentave të Tenderit.

Më datën 04.10.2023 ështe paraqitur ankesë nga OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k.

Ankesa e OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k., pas publikimit të shtojcës së DST për procedurën e sipërcituar, është trajtuar si më poshtë:

1. *Ankesa e OE "V.A.L.E RECYCLING' Sh.p.k., e datës 04.10.2023 (paraqitur nëpërmjet sistemit elektronik ankesave në faqen zyrtare https://kpp.al/AnkesaNeShqyrtim) me objekt modifikimin e dokumentave standarte të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjete e tetë) Leke pa TVSH.*
2. *Urdhër KSHA me Nr. 627, datë 05.10.2023, protokolluar me Nr. 543/22 Prot., datë 05.10.2023, për ngritjen e KSHA-së per shqyrtimin e ankesës dhe urdhërimin e pezullimit të procedures në SPE.*
3. *Me shkresën Nr. 543/24 Prot., datë 10.10.2023 i është kthyer përgjigje OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k., dhe i njoftohet se ankesa e paraqitur për procedurëën e sipërcituar është përanuar pjeserisht, sipas arsyetimit në këtë shkresë.*
4. *Me email-in e datës 11.10.2023 i është dërguar edhe elektronikisht përgjigja e ankesës OE"V.A.L.E RECYCLING Sh.p.k.*
5. *Bashkëlidhur do të gjeni të gjithë dokumentacionin e mësipërm në formë shkresore, kërkesat për sqarim dhe përgjigjet, si dhe DST, shtojcën e modifikimit dhe procesverbalin e argumentimit të kritereve të kualifikimit në CD.*

Duke ju falenderuar,

II.21. Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Shtojca 1 bashkalidhur shkresës nr, 543/21 prot, datë 25.09.2023 "*NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT*" e autoritetit kontraktor lidhur me modifikimin e dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

[...]
Shtoica 1

Lënda: "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Leke pa TVSH.

1. Njoftohen të gjithe OE e interesuar se në pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 të Shtojcën 8, "Kriteret e Veçanta te Kualifikimit", të DST së sipërcituar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

ISHTE:
2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve

spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.1. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,
1.2. Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,
1.3. Makineri për larjen e kontenierëve dhe një makineri back up të tillë (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem) - cope 2.
Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:
- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineria për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te riperdorshem duhet të jenë të pajisur me;
a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim
a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie;
c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*
**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*
** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*
Shenim:
Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

BËHET:
2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i

ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.4 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me të njëjtën metodë back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/ore në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet),
1.5 Impiant/e për asgjësimin me incenerim dhe impiant/e incenerimi back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 11 kg/ore në total ose 176 kg/ditë, në të dyja rastet),
1.6 Makineri për larjen e kontenierëve dhe makineri back up të tillë (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 2
Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:
- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me;

d) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim
a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
e) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.
f) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*
**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*
** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*
Shënim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

ISHTE:
2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise,
• Minimalisht 2 (dy) Dokumenta të Transferimit të Mbetjeve të plotësuara nga ofertuesi me subjektin gjatë 3 muajve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës ku të jetë pasqyruar depozitimi i sejcilit produkt që del nga trajtimi/asgjesimi (kod 19 01 dhe kod 19 03) sipas VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".
"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

BËHET:
2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise.

**<u>Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues</u>.*

Të gjitha të dhënat e tjera mbeten të pandryshuara.[...]

II.22. Me shkresën "*Kërkesë për informacion*" nr. 2434/4 prot, datë 13.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi autoritetit kontraktor informacion, si më poshtë vijon:

"*... Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023 me objekt: "Dërgohet informacion", protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023 është dërguar pranë Komisionit të*
Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.
Për sa më sipër, nisur nga fakti se ankesa e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK është pranuar pjesërisht nga ana e autoritetit kontraktor dhe me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", kërkojmë nga ana juaj që të na informoni lidhur me:
1. Cilin/cilat nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, pasi në dispozitivin e këtij vendimi është vendosur pranimi pjesërisht i pretendimeve të ankimuesit?
Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacionin më sipër cituar.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,".

II.23. Me shkresën "*Kërkesë për informacion*" nr. 2434/5 prot, datë 13.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E Recycling" SHPK, si më poshtë vijon:

"*... Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023 me objekt: "Dërgohet informacion", protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.*
Për sa më sipër, nisur nga fakti se ankesa e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK është pranuar pjesërisht nga ana e autoritetit kontraktor dhe me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", kërkojmë nga ana juaj që të na informoni lidhur me:
1. Me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, a e konsideroni të pranuar pretendimin tuaj të parashtruar në ankimi elektronik me nr. A/2023/3466 dhe me nr. 2434/2023 protokolli, datë 04.10.2023?
2. Nëse nuk i konsideroni të pranuara pretendimet tuaja me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ju lutemi të identifikoni pretendimin tuaj që nuk është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor?

Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj të paraqesni informacionin e kërkuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,".

II.24. Me shkresën nr. 543/28 prot, datë 17.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/6 prot, datë 18.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar me shkresën "*Kërkesë për informacion*" nr. 2434/4 prot, datë 13.10.2023, si më poshtë vijon:

"*Në përgjigje tuajës nr. 2434/4, datë 13.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 543/26, datë 16.10.2023, me anë të të cilës kërkoni informacion lidhur me: "Cilin/cilat nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E RECYCLING" shpk janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24, datë 10.10.2023, pasi në dispozitivin e këtij vendimi është vendosur pranimi pjesërisht i pretendimeve të ankimuesit, sqarojmë si më poshtë vijon:*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur me Urdhërin nr. 627, datë 05.10.2023 ka vendosur, me vendimin nr. 543/24, datë 10. 10.2023, të rekomandojë rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, përkatësisht pika 2.3.5 Makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.4 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me te njëjtën metode back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/orë në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet).

Sqarojmë se në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e OE "V.A.L.E RECYCLING", si vijon:

Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit e konkretisht të shoqërisë së lartpërmendur, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensën në procedurat e prokurimit publik. Në këte rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurencën dhe lehtësimin e procedurës për shpalljes fitues të subjektit ECO RICIKLIM.

Së dyti nuk kemi një sigurim të fondeve publike, pasi a) vetëm një operator ekonomik do të jetë në treg i cili do të përcaktojë dhe çmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurencës, zhvillimi dhe përcaktimi i çmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirësigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga nje operator ekonomik.

Së treti, me veprimet e tij, autoriteti kontraktor jo vetëm nuk po rrit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërise së përcaktuar prejt tyre.

Së katërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkurencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg e në vijim...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nuk ka marrë parasysh pretendimet e sipërcituara, pasi giykoi se këto pretendime ngjajnë me shumë me akuza se me pretendime apo kërkesa që lidhen me ndryshimin e dokumentacionit të prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore.".

II.25. Me shkresën "*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*" nr. 2434/7 prot, datë 27.10.2023, Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi autoritetin kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik ankimues "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 01.11.2023 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.26. Me shkresën "*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*" nr. 2434/7 prot, datë 27.10.2023, Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi autoritetin kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik ankimues "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 01.11.2023 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për paraqitjen e tyre në këtë seancë.

II.27. Në datën 01.11.2023, ora 10:00, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u zhvillua seanca dëgjimorë për shyqrtimin e pretendimeve të ngritura në ankimin elektronik me nr. A/2023/3466 dhe me nr. 2434/2023 protokolli, datë 04.10.2023 të operatorit ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK për procedurën e prokurimit "e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - shërbime", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt: "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore", me fond limit 785,788,138 Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar më datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social.

Kjo seancë dëgjimore u zhvillua në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe inspektorit të dosjes, në prani të përfaqsuesve të autoritetit kontraktor si dhe në prani të përfaqsuesve të operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK

Seanca dëgjimore konsistoi në qartësimin e hapave procedurialë të ndjekur nga ana e autoritetit kontraktor lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet pyetjeve të parashtruara dhe të drejtuara palëve nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING"* SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik",* në të cilin parashikohet se *"1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre"*, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi deri në fazën e dorëzimit të ofertavë.

III.1.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK, për modifikimin e dkumenteve të tenderit dhe anullimin e procedurës, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.2. Në datën 10.03.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. *REF-61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe duke publikuar ne Sistemin Elektronik të Prokurimit dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. *Procesverbalin e hartimit të kritereve kualifikuese dhe të specifikimeve teknike në gjuhën shqipe me emërtimin "**Argumentim kriteresh Mbetjet 2023.docx**"*
2. *Dokumentat e tenderit në gjuhën shqipe me emërtimin "**Procedure_e_Hapur_Sherbime_Mbetjet 2023.doc**".*
3. *Dokumentat e tenderit në gjuhën angleze me emërtimin "**Procedure e Hapur Mbetjet 2023 DST Anglisht.docx**".*
4. *Procesverbalin e hartimit të kritereve kualifikuese dhe të specifikimeve teknike në gjuhën angleze me emërtimin "**Argumentim Kriteresh Mbetjet Anglisht.docx**"*
5. *Dokumentin e specifikimet teknuke dhe termat e referencës në gjuhën angleze me mërtimin "**Aneks 1 Anglisht.pdf**".*
6. *Dokumentin e specifikimet teknuke dhe termat e referencës në gjuhën shqipe me mërtimin "**Aneks 1 Shqip.pdf**".*

III.1.3. Në datën 20.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 588 prot., e operatorit ekonomik "*Eco Empire*" SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.5. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 588/2 prot., datë 27.03.2023 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikim teknik, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*Eco Empire*" SHPK.

III.1.6. Nëpërmjet shkresës nr. 543/10 prot., datë 29.03.2023 protokolluar me tonën me nr. 588/3 prot., datë 30.03.2023 me objekt "*Dërgohet Informacion*", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion dhe vendimi i autoritetit kontraktor nr 543/9 prot, datë 29.03.2023 lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*Eco Empire*" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku konstatohet se ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.7. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 443/2023, datë 30.05.2023, ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Eco Empire" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Eco Empire" SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.8. Me shkresën nr. 543/13 prot., datë 06.07.2023, protokolluar me tonën nr. 588/6 prot datë 07.07.2023, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informon se ka përgatitur modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit në përputhje me vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar",* me Nr. *REF- 61901-03-09-2023,* me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 **(***shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë***)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni vërejti se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik shtojcën e modifikuar nga verifikimi i së cilës u konstatua se ky i fundit nuk kishte kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet dhe interpretimet e vendimit Nr. 443/2023, datë 30.05.2023.

III.1.9. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 543/13 prot., datë 06.07.2023, protokolluar me tonën nr. 588/6 prot., datë 07.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 668/2023, datë 25/07/2023 ka vendosur:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë**)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht Vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.10. Me shkresën nr. 543/16 prot., datë 15.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/8 prot., datë 16.08.2023, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informoi se ka zbatuar vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar",* me Nr. *REF- 61901-03-09-2023,* me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje*

Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 **(***shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë***)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vërejti se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar kkishte dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik shtojcën e modifikuar nga verifikimi i së cilës konstatohet se ky i fundit kishte kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet dhe interpretimet e vendimit Nr. 443/2023, datë 30.05.2023. Por nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik KPP konstatoi se autoriteti kontraktor nuk e kishte publikuar shtojcën e modifikuar në sistemin e prokurimeve elektronike. Ndaj në këto kushte,KPP i la detyrë autoriteti kontraktor se duhej të merrte masa për publikimin e shtojcës përkatëse në përputhje me konstatimet e vendimit nr. 443/2023, datë 30.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.11. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 543/16 prot., datë 15.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/8 prot datë 16.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 793/2023, datë 22/08/2023 ka vendosur:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë**)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Autoriteti kontraktor të marrë masa dhe të publikojë shtojcën e modifikuar të dokumentave të tenderit në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me përcaktimet e Vendimit Nr. 443/2023, datë 30.05.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.12. Në datë 28.08.2023, në zbatim të vendimit nr. 443/2023, datë 30.05.2023 dhe vendimint nr. 793/2023, datë 22/08/2023, të Komisioit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor kishte modifikuar dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. *REF-61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet*

janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit shtojcën përkatëse me emërtimin "***V.3...Shtojce modifikimi mbetjet 2023... sipas vendimit te KPP-se.docx***" dhe përmbajtjen, si më poshtë:

[...]
Shtojca 1

Lënda: "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH.

1. Njoftohen të gjithë OE e interesuar se në pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 të Shtojcën 8, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të DST së sipërcituar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

ISHTE:
2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.1. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,
1.2. Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,
1.3. Makineri për larjen e kontenierëve dhe një makineri back up të tillë (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem) - cope 2.
Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:
- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineria për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te riperdorshem duhet të jenë të pajisur me;
a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim
a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie;
c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*
**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*
** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*
Shenim:
Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

BËHET:
2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.4 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me të njëjtën metodë back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/ore në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet),
1.5 Impiant/e për asgjësimin me incenerim dhe impiant/e incenerimi back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 11 kg/ore në total ose 176 kg/ditë, në të dyja rastet),
1.6 Makineri për larjen e kontenierëve dhe makineri back up të tillë (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 2
Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:
- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me;

d) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
e) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.
f) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*
**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*
** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*
Shënim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

ISHTE:
2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:
• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise,
• Minimalisht 2 (dy) Dokumenta të Transferimit të Mbetjeve të plotësuara nga ofertuesi me subjektin gjatë 3 muajve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës ku të jetë pasqyruar depozitimi i sejcilit produkt që del nga trajtimi/asgjesimi (kod 19 01 dhe kod 19 03) sipas VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".
"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter*

përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.

BËHET:
2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise.
**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*
Të gjitha të dhënat e tjera mbeten të pandryshueshme. [...]

III.1.13. Me shkresën nr. 543/18 prot., datë 29.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/10 prot., datë 31.08.2023, autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informon se ka zbatuar vendimin Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar",* me Nr. *REF- 61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 **(***shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë***)** lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor sqaron se më datë 28.08.2023 ka publikuar në Sistemin e Prokurimieve Elektronike SPE shtojcën e modifikimit të dokumentave të tenderit, Komisionit Prokurimit Publik pasi kreu verifikimet në Sistemin e Prokurimve Elektronike konstatoi se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën e modifikuar në SPE me emërtimin "***V.3...Shtojce modifikimi mbetjet 2023... sipas vendimit te KPP-se.docx***" në përputhje me konstatimet e lënë në vendimet Nr. 443/2023, datë 30.05.2023, Nr. 668/2023, datë 25.07.2023, Nr. 793/2023, datë 22.08.2023.

III.1.14. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 543/18 prot., datë 29.08.2023, protokolluar me tonën nr. 588/10 prot., datë 31.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 856/2023, datë 04/09/2023, ka vendosur:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 14.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.15. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elktronike si auditues Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se më datë 25.09.2023, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistem për këtë procedure prokurimi dokumentin e emërtuar "***543.21 (1).pdf***", por që nuk është publikuar në këtë sistem për tu njohur jo vetëm të gjithë operatorët ekonomik ofertues të mundshëm, por edhe Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.16. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elktronike si auditues Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se më datë 29.09.2023, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistem për këtë procedurë prokurimi dokumentin e emërtuar "***Shtojce modifikimi mbetjet 2023 me miratim KPP vs. eng.docx***", por që nuk është publikuar në këtë sistem për tu njohur jo vetëm të gjithë operatorët ekonomik ofertues të mundshëm, por edhe Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.17. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 04.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2434 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3466 e operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, si dhe anullimin e kësaj procedure prokurimi.

III.1.18. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.19. Më datë 11.10.2023 është dërguar në sistemin elektronik të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK dhe protokolluar me tonën me nr. 2434/2 prot, datë 11.10.2023, duke informuar si më poshtë vijon:

“Lënda: Vendim i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit lidhur me ankesën e OE "V.A.L.E RECYCLING" shpk, lidhur me dokumentacionin procedurës së prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore".

Në përgjigje të ankesës se OE "V.A.L.E RECYCLING" shpk, datë 04.10.2023 konfirmuar në databazën e publikuar nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), sqarojmë si më poshtë:

1.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të mbēshtetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 110 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"

1.2. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, në këto kushte Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit me pezullimin e procedurës u investua për të marrë në shqyrtim objektin e ankesës se operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes

Il.1 Në datë 07.09.2023 Ministria e Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit me objekt "Shērbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore", prokurim - e hapur mbi kufirin e lartë monetar - shērbime.

11.2 Në datën 25.09.2023 në SPE është publikuar shtojca e ndryshimeve për "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhe 36 mujore" me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetë dhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëëind e tridhjet e tetë) Leke pa TVSH.

11.3 Në datën 04.10.2023 OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k. ka paraqitur ankesë, konfirmuar kjo në databazën e publikuar nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), lidhur me dokumentat e tenderit.

Konkretisht ankimuesi ngre pretendimet si vijon:

Rezulton se në SPE është publikuar procedura e prokurimit publik me objekt “shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore”, me ak ministria e shendetesise dhe mbrojtjes sociale.
Fillimisht kjo procedurë prokurimi është pezulluar pas një ankimi administrativ të kryer pranë komisionit të prokurimit publik nga një subjekt i tretë palë e interesuar për këtë procedurë prokurimi.
Pas vendimarrjes së komisionit të prokurimit publik, AK, me datë 25.09.2023 ka ngarkuar në SPE shtojcën e re të ndryshimeve të kritereve të tenderit.

Brenda afatit ligjor (10 ditë nga dita e publikimit të shojcës në SPE) paraqesim këtë ankesë pranë AK-së dhe KPP-së përsa më poshtë vijon.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmërinë në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Fillimisht nga AK në DST është kërkuar:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:
1.1 Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,
1.2 Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,

Më pas, ky kriter është ndryshuar si më poshtë:

<u>2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:</u>
<u>1.1 Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,</u>
<u>1.2 Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - copë 2,</u>

Në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është ngarkuar dhe dokumenti i emërtuar "Argumenti i Kritereve Mbetjet 2023" autoriteti kontraktor citon se;
"Për të përllogaritur kapacitetet minimale të kërkuara, për secilin impiant, është marrë për bazë sasia totale e parashikuar për gjithë periudhën, e përllogaritur në sasi mesatare ditore duke prezumuar punë të pandërprerë të impianteve për 365 ditë në vit dhe më tej është përllogaritur kapaciteti orar, duke prezumuar impiantet në gjendje pune për 16 ore (dy turne).
Grupet sipas metodës së trajtimit Sasi 36 muaj në kg Sasi 12 muaj në kg Sasi ditore në kg Sasi në kg/ore
Asgjesim me incenerim (18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe); 18 01 06; 18 01 07; 18 01 08; 18 01 09) 190,177.00 63,392.00 173.00 11.00

Trajtim me metoda të ndryshme nga incenerimi (18 01 01; 18 01 02 (përveç pjesë të trupit dhe organe); 18 01 03; 18 01 04) 1,970,115.00 656,705.00 1,799.00 112.00
Duke mbajtur në konsideratë, se impiantet do jenë në gjendje pune të vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohet edhe një makineri back up, për secilin impiant me të njëjtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licensat përkatëse, çka sërish do të shkaktonte ndërprerje me muaj të shërbimit.
Lejet e kërkuara për objektin/et e dhënë/a me qera vërtetojnë se këto pajisje janë të licensuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky ceritfikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e tretë ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë.
Fokusi i kësaj kërkese është tek impianti dhe jo tek personat e tretë të cilët japin me qera apo huapërdorje.
Duke qënë një procedurë e përqëndruar me kërkesa nga të gjitha spitalet publike, ky shërbim do të jetë i vazhdueshëm dhe me dinamika të ndryshme në rang territori kombëtar. Kërkesat për marrjen e mbetjeve ditore nuk mund të përcaktohen paraprakisht pasi dhe vetë spitalet nuk mund të parashikojnë gjenerimet në bazë ditore çka do të bënte një calendar të saktë për OE. Afatet kohore për grumbullimin e mbetjeve janë taksative nga pikëpamja ligjore dhe të ndryshme sa i takon rrymave të tyre. Rrjedhimisht kjo gjë kërkon me patjetër nga OE grumbullimin e mbetjeve sipas kërkesave të AK-ve në kohë të ndryshme çka e ben këtë shërbim të vazhdueshëm dhe të paparashikueshëm. Një system reserve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të forcës madhore (mbi ngarkesë në sasitë) etj.
Sqarojmë se studimi i tregut dhe i gjithë dokumentacioni vijues është kryer nga autorieti kontraktor, vetëm me 1 qëllim, pengimin e konkurencës dhe paracaktimin e subjektit fitues, i cili është shoqëria "ECO Riciklim" shpk. Siç do të provojmë më poshtë, tashmë fituesi i kësaj procedure prokurimi është paracaktuar dhe zhvillimi i procedurës së hapur është thjesht fiktiv.

...

Me veprimet e tij, autoriteti kontraktor, me zhvillimin e kësaj procedure prokurimi me këtë kriter të vendosur ka cënuar çdo parim dhe qëllim të vendosur nga ligjvënësi. pse e themi këtë?!

Së pari, në fushën objekt prokurimi rezultojnë të operojnë vetëm 4 kompani, e konkretisht:
1. V.A.L.E Recycling shpk
2.Medi Tel shpk
3. Pura-Medical shpk
4. Eco Riciklim shpk

Çuditërisht, vetëm shoqëria Eco Riciklim shpk (shoqëria e paracaktuar fituese), referuar dhe dokumentacionit shoqërues të ankesës rezulton të ketë kapacitetin e kërkuar nga ak si më sipër, ndërsa të tre subjektet juridik të marrë së bashku nuk e arrijnë dot kufirin minimal të vendosur nga ana e autorietit kontraktor per kapacitetin e autoklaves.
Për çudi, rezulton se kjo shoqëri është licensuar vetëm 3 muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe pikërisht me të njëjtin kapacitet të vendosur si kriter nga ak në dst. ajo që e bën më dyshuese faktin është se pavarsisht se kjo shoqëri është licensuar në muajin dhjetor 2022, instalimin dhe inagurimin e impiantëve e ka kryer vetëm 10 ditë para publikimit të zhvillimit të procedurës Shiko linkun (https://ëëë.ecosteryl.com/un-site-magnifique-pour-traiter-les-dechets-medicaux-en-lbanie/)
Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit e konkretisht të shoqërisë se lartpermendur, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensën në procedurat e prokurimit pubik.
Në këtë rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin, thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurencën dhe lehtësimin e procecudrës për shpalljes fitues të subjektit ECO RICIKLIM.
Së dyti, nuk kemi një sigurim të fondeve publike pasi a) vetëm një operator ekonnomik do të jetë në treg i cili do të paracaktojë dhe cmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurencën, zhvillimi dhe përcaktimi i cmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirësigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga një operator ekonomik.

Së treti, me veprimet e tij, autoretit kontraktor jo vetëm nuk po nxit pjesmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërisë se paracaktuar prej tyre.

Së kartërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkuencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg.

Në analizë të dispozitave ligjore të LPP-së, sqarojmë se, autoriteti kontraktor gjatë përcaktimit të kritereve të veçanta duhet të shmangi çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, e cila përbën diskriminim ndaj një ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. por në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese (aëard criteria), për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre.

Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

AK është i detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e LPP-së në hartimin e kritereve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë të hapur dhe

gjithëpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.
Synimi bazë i autoritetit kontraktor është realizimi i kontratës objekt prokurimi (përfitimi) i punimeve referuar standardeve të caktuara. Në lidhje me mekanizimin për realizimin e synimit të vendosur nga autoriteti kontraktor, gjykojmë se nuk gjendet në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.
Kriteret teknike të vendosura nëpërmjet specifikimeve teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustifikuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.
Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

...

Njësia e prokurimit etj me dashje dhe me anë të veprime/mosveprimeve konkrete kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrat e ngarkuara nga ligji. pra veprimet e tyre janë tërësisht abuzive nga ajo se cfarë duhet të bënin në fakt këto komisione. e drejta e garantuar me ligj nuk është përdorur në këtë rast në mënyrën e duhur në interes të ligjit dhe të së mirës shoqërore por me veprimet e tyre kanë vepruar kundër saj. asnjë prej veprimeve apo mosveprimeve të tyre nuk përligjen dhe nuk burojnë nga e drejta e përcaktuara nga dispozitat ligjore të sipërcituara por janë rezultat i interesave të ngushta vetjake dhe me efekt të kundërt ndaj të mirës shoqërore.

Sa më sipër, përfundimisht kërojmë nga autoriteti kontraktor dhe kpp anullimin e proceudrës së prokurimit.

III. Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, pasi shqyrtoi ankesën dhe dokumentacionin që disponon në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit,

Arsyeton:

OE "V.A.LE. RECYCLING" shpk, në mënyrë të përmbledhur pretendon për mosplotësim të kritereve nga ky operator dhe disa të tjere.

Në këtë rast Operatori Ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. shprehet për kapacitetet teknike të operatorëve ekonomik si më poshtë:

V.A.L.E recycling shpk

Medi - Tel shpk
Pura-Medical shpk
ECO RICIKLIM shpk
Se të tre subjektet juridik të marrë së bashku nuk e arrinë dot kufirin minimal të vendosur nga ana e autorietit kontraktor për kapacitetin e autoklavës.

KSHA, ka shayrtuar Dokumentat Standarde të Tenderit dhe shprehet:

Bazuar në VKM, KREU XII, ANKIMI ADMINISTRATIV, Neni 94, Paraqitja e ankesave pika 1: "1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cila pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.".

KSHA ngritur me Urdhërin Nr. 627 prot, datë 05.10.2023 (Nr. 543/22 Prot., datë 05.10.2023) duke pasur parasysh zbatimin me rigorozitet të ligjit Nr. 162/2020 "PËR PROKURIMIN PUBLIK" dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", verifikoi pretendimet e ngritura nga ky operator, si dhe shtojcën e publikuar ne APP "V.3...Shtojce modifikimi mbetiet 2023 sipas vendimit te KPP-se.docx", ku për këtë kriter janë bërë ndryshimet si më poshtë:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të giitha kategorive të mbetjeve objekt i këtyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, si dhe të VKM-së për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.1 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me të njëjtën metode back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/orë në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet),
1.2 Impiant/e për asgjesimin me incenerim dhe impiant/e incenerimi back up (impianti/et duhel të përmbushin kapacitetin minimal 11 kg/orë në total ose 176 kg/ditë, ne të dyja rastet),
1.3 Makineri për larjen e kontenierëve dhe makineri back up të tillë (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshëm)-- minimalisht copë 2.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjesimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm duhet të jenë të pajisur me;

a. 1. Leje Mjedisore të tipit A (I11. 1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim a.2. Leje Miedisore të tipit A (III. 1.C) ose të tipit B (III. I.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente) ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
Katalog ose skedë teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kērkesën e me sipërme.
Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

Në vijim KSHA shprehet:

Sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT".

Ky ligi percakton: Neni 23 "Menaxhimi i informacionit, pika I: "1. Të gjitha informacionet, lidhur me instalimet e kategorive A dhe B, bëhen publike dhe janë pjesë e sistemit të informacionit mjedisor, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"

Në këto të dhëna merret dhe informacioni për kapacitetet që këto subjekte të licensuara zotërojnë.

KSHA kërkoi në sistemin elektronik Qendrës Kombëtare të Biznesit https://gkb.gov.al/kerko/kerko-ne-registrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/) për subjektet e cituara nga ankimuesi si dhe vetë ankimuesin, të cilat kanë si objekt trajtimin e mbetjeve dhe që janë licensuar me licensat e lejimit të ushtrimit të aktivitetit me Leje Mjedisore të tipit A, në mënyrë që të verifikonte kapacitetet e impjanteve, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. MEDI-TEL SHPK me NIPT: J71519004Ë
Leja datë 27.06.2016, numër 2193, pika 2.2 përcaktohet: "Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi, incenerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incenerimi. Sipërfaqja e sheshit ku zhvillohet veprimtaria është 4200 m^2. Kapaciteti i projektuar është më shumë se 1 ton/orë.

2. PURA-MEDICAL SHPK me NIPT: L71515507M
Leja datë 17.07.2023, numër 2909/3, pika 2.2 përcaktohet: ID 5.1/ Incenerimi imbetjeve të rrezikshme në në instalim incenerimi. ID 5.1 c Incenerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjeve e kafshēve në një instalim incenerimi përveç atij të referuar në pikën 5.1 a. ID 5.3/a Asgjesimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose landfilldim (5.2 a).
Sipërfaqja totale ku zhvillohet aktiviteti 852 m^2, me sipërfaqe truall 740 m^2, nga e cila 148 m^2 sipërfaqe ndërtese. Kapaciteti i projektuar i autoklavës është 1000 kg/cikël dhe kapaciteti i inceneratorit është 30 kg/cikël.

3. ECO RICIKLIM me NIPT: L61814009B
Leja datë 09. 11.2022, numër 2988/2, pika 2.2 përcaktohet: ID 5.1/a Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. ID 5.1 c Incenerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjeve

e kafshēve në një instalim incenerimi përveç atij të referuar në pikën 5.1 a. ID 5.3/a Asgjesimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit (5.1 a) ose landfilldim (5.2 a).
ID 12.1/b Incenerim i mbetjeve patologjike. Kapaciteti i projektuar për inceneratorët:
Kapaciteti për incenerim P25 MI është 100 kg/orë. Kapaciteti i projektuar për strerilizim/asgjesim: Kapaciteti i sterilizimit ECOSTERYL është 250-300 kg/orë (2-7 ton/ditë). Kapaciteti i sterilizimit më afër të NeëSter 50 është 90-110 kg/orë (janë 2 copë) 180-220 kg/orë. Sterilizuesi Neëster të mbetjeve spitalore infektive do të punojnë 24h pra, kapaciteti i mbetjeve spitalore do të jetë 4320-5280 kg/24 orë...

4. V.A.L.E. RECYCLING me NIPT: L28029301Q
Leja datë 22.04.2022, numër 2929/2, pika 2.2 përcaktohet se ID 5.1/ Incenerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi. ID 12.1/b Incenerim i mbetjeve patologjike. Sipërfaqja e objektit ku zhvillohet veprimtaria është 355.87 m^2. Kapaciteti i projektuar për një impiant incenerimi është 30-50 kg/cikël, ndërsa për funksionimin njëkohësisht të dy impianteve të incenerimit është 60-100 kg/cikël.

KSHA në zbatim të parimit themelor të ligjit të prokurimit publik, pas verifikimit të pretendimeve të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k.,

Vendos:

1. <u>Të pranojë pjesërisht ankesên e paraqitur nga OE "V.A.LE. RECYCLING" shpk</u>, për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuader me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Leke pa TVSH. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023: 6,868,777 Euro pa TVSH. REF-61901-03-09-2023 Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – shërbime - prokurim me mjete elektronike, me arsyetimin e lartëpërmendur.
<u>2. Të rekomandojë rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Liglit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar;</u>
3. Ky vendim i komunikohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Komisionit të Prokurimit Publik dhe OE "V.A.LE. RECYCLING" shpk, (edhe në adresën e email - recycling.vale@gmail.com) nga personat përgjegjës për prokurimin në zbatim të pikave 2, 3 dhe 4, të urdhërit nr. 627, datë 05.10.2023.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin. [...]

III.1.20. Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK, duke informuar si më poshtë vijon:

[...]

Në zbatim të pikës 4 të nenit 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12.2020 "Për prokurimin publik", AK Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale në përfundim të shqyrtimit të ankesës së ardhur nga OE "V.A.L.E RECYCLING» Sh.p.k., për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" me fond limit 785,788, 138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatēqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e teë2) Leke pa TVSH, REF-61901-03-09-2023, ju informojmë sa më poshë vijon:

Në datë 10.03.2023 në sistemin elektronik të prokurimeve është publikuar procedura e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhe 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të githa kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pese milion e shtatëqind e tetëdhjete e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Leke pa TVSH. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023: 6,868,777 Euro pa TVSH, REF-61901-03-09-2023, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - shërbime.

Më datën 25.09.2023 është publikuar në SPE Shtojca për Njoftim për Ndryshimin e Dokumentave të Tenderit.

Më datën 04.10.2023 ështe paraqitur ankesë nga OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k.

Ankesa e OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k., pas publikimit të shtojcës së DST për procedurën e sipërcituar, është trajtuar si më poshtë:

1. *Ankesa e OE "V.A.L.E RECYCLING' Sh.p.k., e datës 04.10.2023 (paraqitur nëpërmjet sistemit elektronik ankesave në faqen zyrtare https://kpp.al/AnkesaNeShqyrtim) me objekt modifikimin e dokumentave standarte të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjete e tetë) Leke pa TVSH.*
2. *Urdhër KSHA me Nr. 627, datë 05.10.2023, protokolluar me Nr. 543/22 Prot., datë 05.10.2023, për ngritjen e KSHA-së per shqyrtimin e ankesës dhe urdhërimin e pezullimit të procedures në SPE.*
3. *Me shkresën Nr. 543/24 Prot., datë 10.10.2023 i është kthyer përgjigje OE "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k., dhe i njoftohet se ankesa e paraqitur për procedurëën e sipërcituar është përanuar pjeserisht, sipas arsyetimit në këtë shkresë.*
4. *Me email-in e datës 11.10.2023 i është dërguar edhe elektronikisht përgjigja e ankesës OE"V.A.L.E RECYCLING Sh.p.k.*
5. *Bashkëlidhur do të gjeni të gjithë dokumentacionin e mësipërm në formë shkresore, kërkesat për sqarim dhe përgjigjet, si dhe DST, shtojcën e modifikimit dhe procesverbalin e argumentimit të kritereve të kualifikimit në CD.*

Duke ju falenderuar,

III.1.21. Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa nr, 543/21 prot, datë 25.09.2023 "*NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT*" e autoritetit kontraktor lidhur me justifikimin për modifikimin e dokumentave të tenderit në pikën 9, si dhe lidhur me ndryshimin e afatit të pranimit të ofertave në pikën 10 të kësaj shkrese, si më poshtë vijon:

"*9. Justifikimi, argumentat përkatës dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit: Në zbatim të Vendimit Nr. 443/2023 i datës 30.05.2023, Nr. 668/2023, datë 23.07.2023, Nr. 793/2023, datë 23.08.2023 dhe Nr. 856/2023 datë 04.09.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.*

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: PO

***Ishte**:*
14/04/2023 ora 10:00

***Bëhet**:*
24/10/2023 ora 10:00

Shënim
Këtij njoftimi duhet t'i bashkangjitet shtojca e ndryshimeve në doumentat e tenderit.",

III.1.22. Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Shtojca 1 bashkalidhur shkresës nr, 543/21 prot, datë 25.09.2023 "*NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT*" e autoritetit kontraktor lidhur me modifikimin e dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

[...]
Shtojca 1

Lënda: "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj" - me fond limit në total prej 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Leke pa TVSH.

1. Njoftohen të gjithe OE e interesuar se në pikat 2.3.5 dhe 2.3.6 të Shtojcën 8, "Kriteret e Veçanta te Kualifikimit", të DST së sipërcituar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

ISHTE:
2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST,

sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.1. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) me kapacitet minimal 110 kg/ore dhe impiant me të njëjtën metodë back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,

1.2. Impianti për asgjësimin me incenerim me kapacitet minimal 11 kg/ore dhe impiant incenerimi back up me të njëjtin kapacitet minimal - cope 2,

1.3. Makineri për larjen e kontenierëve dhe një makineri back up të tillë (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem) - cope 2.

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineria për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te riperdorshem duhet të jenë të pajisur me;

a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie;

c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*

**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

BËHET:

2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST,

sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores "Per menaxhimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.4 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me të njëjtën metodë back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/ore në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet),

1.5 Impiant/e për asgjësimin me incenerim dhe impiant/e incenerimi back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 11 kg/ore në total ose 176 kg/ditë, në të dyja rastet),

1.6 Makineri për larjen e kontenierëve dhe makineri back up të tillë (vetem në rastin kur do të përdoren kontenierë të ripërdorshëm)– minimalisht copë 2

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huaperdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

- Impiantet për trajtimin/asgjësimin dhe njëkohësisht makineritë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve te ripërdorshem duhet të jenë të pajisur me;

d) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjesimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit (teknologji autoklavim ose ekuivalente)ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

e) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerie, ku të pasqyrojë kapacitetin minimal të kërkuar në përputhje me kërkesën e mësipërme.

f) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerie.

**Shënim nr. 1: KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet sa me siper.*

**Shënim nr. 2: Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*

Shënim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

ISHTE:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise,

• Minimalisht 2 (dy) Dokumenta të Transferimit të Mbetjeve të plotësuara nga ofertuesi me subjektin gjatë 3 muajve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës ku të jetë pasqyruar depozitimi i sejcilit produkt që del nga trajtimi/asgjesimi (kod 19 01 dhe kod 19 03) sipas VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

"Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

**Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues.*

BËHET:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitimin e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 03 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) me kodin 19 01. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

• Kontratë me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjesimi/trajtimi brenda afatit te vlefshmerise.

**<u>Plotësimi i kriterit të mësipërm është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nga OE të huaj ky kriter përmbushet duke u bazuar në legjislacionin e vendit të origjinës shoqëruar me dokumentacion provues</u>.*

Të gjitha të dhënat e tjera mbeten të pandryshuara.[...]

III.1.23. Me shkresën "*Kërkesë për informacion*" nr. 2434/4 prot, datë 13.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi autoritetit kontraktor informacion, si më poshtë vijon:

"*... Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023 me objekt: "Dërgohet informacion", protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023 është dërguar pranë Komisionit të*

Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK për

procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.
Për sa më sipër, nisur nga fakti se ankesa e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK është pranuar pjesërisht nga ana e autoritetit kontraktor dhe me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", kërkojmë nga ana juaj që të na informoni lidhur me:
1. Cilin/cilat nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, pasi në dispozitivin e këtij vendimi është vendosur pranimi pjesërisht i pretendimeve të ankimuesit?
Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacionin më sipër cituar.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,".

III.1.24. Me shkresën "*Kërkesë për informacion*" nr. 2434/5 prot, datë 13.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E Recycling" SHPK, si më poshtë vijon:

"*... Me shkresën nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023 me objekt: "Dërgohet informacion", protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.*
Për sa më sipër, nisur nga fakti se ankesa e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK është pranuar pjesërisht nga ana e autoritetit kontraktor dhe me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga shoqëria "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", kërkojmë nga ana juaj që të na informoni lidhur me:
1. Me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, a e konsideroni të pranuar pretendimin tuaj të parashtruar në ankimi elektronik me nr. A/2023/3466 dhe me nr. 2434/2023 protokolli, datë 04.10.2023?
2. Nëse nuk i konsideroni të pranuara pretendimet tuaja me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ju lutemi të identifikoni pretendimin tuaj që nuk është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor?
Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj të paraqesni informacionin e kërkuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,".

III.1.25. Me shkresën nr. 543/28 prot, datë 17.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/6 prot, datë 18.10.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar me shkresën "*Kërkesë për informacion*" nr. 2434/4 prot, datë 13.10.2023, si më poshtë vijon:

"*Në përgjigje tuajës nr. 2434/4, datë 13.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 543/26, datë 16.10.2023, me anë të të cilës kërkoni informacion lidhur me: "Cilin/cilat nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E RECYCLING" shpk janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24, datë 10.10.2023, pasi në dispozitivin e këtij vendimi është vendosur pranimi pjesërisht i pretendimeve të ankimuesit, sqarojmë si më poshtë vijon:*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur me Urdhërin nr. 627, datë 05.10.2023 ka vendosur, me vendimin nr. 543/24, datë 10. 10.2023, të rekomandojë rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, përkatësisht pika 2.3.5 Makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

1.4 Impiant/e për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) dhe impiant/e me te njëjtën metode back up (impianti/et duhet të përmbushin kapacitetin minimal 110 kg/orë në total ose 1760 kg/ditë, në të dyja rastet).

Sqarojmë se në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e OE "V.A.L.E RECYCLING", si vijon:

Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit e konkretisht të shoqërisë së lartpërmendur, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensën në procedurat e prokurimit publik. Në këte rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurencën dhe lehtësimin e procedurës për shpalljes fitues të subjektit ECO RICIKLIM.

Së dyti nuk kemi një sigurim të fondeve publike, pasi a) vetëm një operator ekonomik do të jetë në treg i cili do të përcaktojë dhe çmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurencës, zhvillimi dhe përcaktimi i çmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirësigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga nje operator ekonomik.

Së treti, me veprimet e tij, autoriteti kontraktor jo vetëm nuk po rrit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërise së përcaktuar prejt tyre.

Së katërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkurencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg e në vijim...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nuk ka marrë parasysh pretendimet e sipërcituara, pasi giykoi se këto pretendime ngjajnë me shumë me akuza se me pretendime apo kërkesa që lidhen me ndryshimin e dokumentacionit të prokurimit me objekt "Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore.".

III.1.26. Me shkresën "*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*" nr. 2434/7 prot, datë 27.10.2023, Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi autoritetin kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik ankimues "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 01.11.2023 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.27. Me shkresën "*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*" nr. 2434/7 prot, datë 27.10.2023, Komisionit të Prokurimit Publik, njoftoi autoritetin kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik ankimues "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 01.11.2023 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për paraqitjen e tyre në këtë seancë.

III.1.28. Në datën 01.11.2023, ora 10:00, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u zhvillua seanca dëgjimorë për shyqrtimin e pretendimeve të ngritura në ankimin elektronik me nr. A/2023/3466 dhe me nr. 2434/2023 protokolli, datë 04.10.2023 të operatorit ekonomik "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK për procedurën e prokurimit "e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - shërbime", me Nr. REF-61901-03-09-2023, me objekt: "Shërbimi i trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore", me fond limit 785,788,138 Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar më datë 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social.

Kjo seancë dëgjimore u zhvillua në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik dhe inspektorit të dosjes, në prani të përfaqsuesve të autoritetit kontraktor dhe në prani të përfaqsuesve të operatorit ekonomik ankimues.

Seanca dëgjimore konsistoi në qartësimin e hapave procedurialë të ndjekur nga ana e autoritetit kontraktor lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet pyetjeve të parashtruara dhe të drejtuara palëve nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik i drejtoi një grup pyetjesh autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues në lidhje me vendimarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor për ankesën e operatorit ekonomik "*VALE RECYCLING*"shpk. Konkretisht, në nenin 115 të ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*"të ndryshuar parashikohen kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik vecanërisht në rastin kur autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën pra, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër. Duke marrë në konsideratë aktin e trajtimit të ankesës së autoritetit kontraktor, KPP konstatoi se kjo e fundit nuk është e qartë mbi elementët e ankesës së pranuar nga ana e autoritetit kontraktor. Ndaj, para marrjes së masave për zhvillimin e një

seance dëgjimore Komisioni i kërkoi edhe një herë sqarim autoritetit kontraktor mbi pjesën e pranuar, ndërkohë kërkoi edhe një vlerësim nga ana ankimuesit nëse referuar trajtimit të ankesës, kjo e fundit konsiderohet e pranuar. Kjo për vetë faktin se Komisioni i Prokurimit Publik ka parashikuar në nenin nenit 42, pika 5 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*" ku parashikohet se : 'Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë ankimues mund të paraqesin pranë KPP-së qëndrimin e tyre me shkrim lidhur me vendimarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës së autoitetit kontraktor, nga e nesërmja e vënies në dijeni të kësaj vendimarrje.

Me qëllim një vendimarrje transparente, por edhe për ti mundësuar operatorëve ekonomikë një mjet ankimi efektiv, *omisioni i drejton 2 pyetje autoritetit kontraktor s, si më poshtë vijon:*

1. Cilin/cilat nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. RECYCLING" SHPK janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023
2. Në përfundim të rekomandimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave a ka marrë masa Njësia e Prokurimit për hartimin e shtojcës për modifikimin e kritereve kualifikuese dhe në rast se po cili është akti dhe a është publikuar kjo shtojcë në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në përgjigje të pyetjes së parë *përfaqësuesi i autoritetit kontraktor deklaron se:*
Është marrë pjesërisht në shyqrtim ankesa dhe konkretisht pretendimi lidhur me kapacitetin teknik dhe fillon të citojë vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023 dhe konkretisht dispozitivin e këtij vendimi.

Gjithashtu, Komisioni i drejtoi pyetjen si më poshtë:

Cila pjesë e ankesës nuk është marrë në shqyrtim nga KSHA?
Për këtë pyetje përfaqësuesi i autoeritetit kontraktor deklaroi se: (Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit e konkretisht të shoqërisë se lartpermendur, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensën në procedurat e prokurimit pubik.
Në këtë rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin, thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurencën dhe lehtësimin e procecudrës për shpalljes fitues të subjektit ECO RICIKLIM.
Së dyti, nuk kemi një sigurim të fondeve publike pasi a) vetëm një operator ekonnomik do të jetë në treg i cili do të paracaktojë dhe cmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurencën, zhvillimi dhe përcaktimi i cmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirësigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga një operator ekonomik.

Së treti, me veprimet e tij, autoretit kontraktor jo vetëm nuk po nxit pjesmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërisë se paracaktuar prej tyre.

Së kartërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkuencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg.) duke u shprehur se KSHA-ja gjykoi se këto pretendime të OE ngjajnë më shumë me akuza se me pretendime apo kërkesa që lidhen me ndryshimin e dokumentacionit të prokurimit me objekt (objekti i prokurimit)

Në vijim të seancës, për sqarim të fakteve, Komisioni i drejtoi pyetjen autoritetit kontraktor:

"Ju si Komision i Shqyrtimit të Ankesave referuar aktit nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023 konstatohet se keni bërë një kërkim në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit ku ka evidentuar kapacitete të disa operatorëve ekonomikë që ishin përmendur nga ankimuesi dhe ku pas këtij konstatimi ju si KSHA me vendimmarrjen tuaj krahas rekomandimit a keni bërë një propozim konkret mbi mënyrën se si do të modifikohet shtojca apo është lënënë vlerësimin e njësisë së prokurimit mbi mënyrën se si do të hartohet kjo shtojcë në përfundim të rekomandimit të dhënë nga KSHA-ja?".

Ndërkohë, përfaqësuesi i autoritetit kontraktori deklaroi se:

" *është cituar cituar në pikën 2 (dy) të vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, se: "2. Të rekomandojë rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Liglit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.".*

Komisioni i drejtoi sërish pyetjen se : Pra nuk ka një rekomandim konkret nga ana e KSHA-së, por ka një rekomandim të përgjithshëm që njësia e prokurimit?
Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor sqaron se , ky rekomandim është plotësuar me rekomandimin për rishikimin e kapacitetit teknik.

Ndërkohë, KPP i drejtoi edhe pyetje përfaqësuesit të Njësisë së Prokurimit, të autoritetit kontraktor se:

"Njësia e prokurimit në vijim të vendimmarrjes së KSHA-së a ka marrë masa për hartimin e shtojcës?".

Përfaqësuesja e autoritetit kontraktor u shpreh se*:*

"njësia e prokurimit pas njohjes me vendimin e KSHA-së, korespondëncës me KPP-në dhe korespondencës me operatorin ekonomik (në vijim të kërkesave për sqarim dhe përgjigjeve përkatëse) nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me modifikimin e dokumentave të tenderit për pjesën e pranuar, pasi kjo pjesë nuk është shumë e qartë se çfarë ishte vendosur dhe ka pritur vendimin deklarativ të KPP-së.".

Gjithashtu, KPP i drejtoi pyetjen si në vijim:

"Ju si njësi prokurimi brenda autoritetit kontraktor deklaroni që vendimmarrja e KSHA-së nuk është e qartë as për ju?

Përfaqësuesja e autoritetit kontraktor anëtare e njësisë së prokurimit shprehet se:

"është pjesërisht e qartë.".

Gjithashtu, KPP i ridrjetoi pyetjen si më poshtë:

"Cilën pjesë të vendimmarrjes së KSHA-së ka të qartë njësia e prokurimit.".

Përfaqësuesja e autoritetit kontraktor u shpreh se:

"Për vetë faktin se që ju vetë pyetët, që nuk propozohet diçka konkrete lidhur me ndryshimin e kriterit, por është e përgjithshme.".

Gjithashtu në seancë Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua edhe operatorit ekonomik duke i kërkuar si më poshtë:

"*Që të identifikojë se cili pretendim i juaji është pranuar dhe cili pretendim i juaji është refuzuar nga ana e autoritetit kontraktor referuar ankesës tuaj,në mënyrë që Komisioni i Prokurimit Publik të vijojë me hapat e mëtejshëm në përputhje me parashikimet e nenit 115 të LPP-së?"*.

Në seancën dëgjimore, përfaqsuesi i operatorit ankimues shprehet si në vijim: *"Nga ana e përfaqsuesit të KSHA-së u lexua thjesht vendimi i KSHA-së dhe nuk u qartësua se si ky vendim do zbatohet, si dhe cili është ndryshimi që propozohet nga ana e KSHA-së në mënyrë që edhe ne të shprehemi nëse kemi kundërshtime apo kemi pranime në lidhje me kriterin. Edhe zonja e njësisë së prokurimit u shpreh që pret një vendim deklarativ nga ana e KPP-së, ndërkohë që unë nuk e di se si mund të dalë me një vendim deklarativ KPP-ja kur nuk ka një propozim konkret se si do të ndryshohet kushti, si ishte dhe si mendohet të bëhet. Nëqoftëse nuk kemi një propozim konkret është e kotë që të vazhdojë kjo procedurë administrative, sepse vete neni 114 i LPP-së ku ne na jepë të drejtën që të paraqesim kundërshtimet tona brenda 5 (pesë) ditëve, domethënë për çfarë mund të paraqesim kundërshtimet ose pranimet, kur nuk dimë se si do të hartohet ky kusht apo si do të plotësohet ky kusht, dhe për të qartësuar diçka."*.

III.1.33. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Ndërkohe në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."

III.1.34. Në nenin 21 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.
Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.
3. Kur një ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t'ia delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti ose enti tjetër kontraktor.
4. Në autoritetin ose entin kontraktor caktohet personi përgjegjës për prokurimin, i cili administron në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit, si dhe ngrihet njësi prokurimi për çdo objekt që prokurohet. Personi përgjegjës duhet të kenë minimalisht një kualifikim sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.
5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.
6. Rregulla më të hollësishme për zbatimin e pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.".

III.1.35. Në nenin 74 "*Dokumentet e tenderit*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.*

2. Autoritetet ose entet kontraktore, nëpërmjet mjeteve elektronike, ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi. Kur mënyra e thirrjes për konkurrim është një njoftim për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ky akses ofrohet jo më vonë nga momenti i dërgimit të ftesës për ofertë ose për të negociuar. Përmbajtja e njoftimit ose ftesës për shprehje interesi specifikon adresën e internetit, ku mund të gjenden dokumentet e prokurimit.
3. Kur nuk mund të ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, autoritetet kontraktore ose entet mund të përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi se këto dokumente tenderi do t'u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike. Në këtë rast, afati për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 ditë.
4. Në rastet kur objekti i prokurimit nuk zhvillohet me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor, me kërkesë të operatorëve ekonomikë, duhet të vërë në dispozicion të të interesuarve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës, me një çmim i cili nuk duhet të tejkalojë atë që është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet për kopjimin e dokumenteve të tenderit. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.".

III.1.36. Në nenin 75 "*Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*
Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.
Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.
2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce.
Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.
Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.
3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.".

III.1.37. Në pikat 2 dhe 5 të nenit 24, "*Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët*" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimin Publik"*, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

"*2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*
Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.
5. Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti/enti kontraktor vendos të organizojë një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë, të interesuar për të marrë pjesë në tender, duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, autoriteti/enti kontraktor mund të organizojë një konferencë 1paraprake (edhe në rastin e mallrave), ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve.
Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit/entit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kërkuar dokumentet e tenderit.
Në rastin e procedurave të prokurimit me mjete elektronike, kërkesat për sqarim bëhen sipas udhëzimeve të APP-së.
Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 75, të LPP-së, dhe me këto rregulla.".

III.1.38. Në nenin 110 "*Afatet për ankim*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.*
Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.
2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.
3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.
Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.
4. Në rastin e procedurave për rihapjen konkurrimit për lidhjen e një kontrate, në bazë të një marrëveshjeje kuadër me disa operatorë ekonomikë, me procedurë prokurimi mbi kufirin e lartë monetar, afati për paraqitjen e ankesave është 10 ditë nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës.

Në rastin e kontratave të lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me vlerë nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.
5. Në rastin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit. Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.
6. Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë ligj dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.
Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.".

III.1.39. Në nenin 114 "*Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. 2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.
Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.
3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:
a) pranimin e plotë të ankesës;
b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
c) refuzimin e ankesës.
4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.
6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.".

III.1.40. Në nenin 115 "*Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*
a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.
3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:
a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;
b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.
4. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor nuk ka marrë vendim sipas përcaktimeve të nenit 114 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afatit të mësipërm, i kërkon dërgimin e informacionit apo dokumentacionit përkatës.

Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni, ka detyrimin të paraqesë në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.
Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.
Për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është jo më vonë se 20 ditë.
5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.
Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët.".

III.1.41. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dy ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik është ai i sigurimit të një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe sigurimit të integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.
Sa më sipër, KPP gjykon se nuk mund të shprehem mbi themelin e ankesës, duke qenë se është plotësisht e pamundur të kryhet një vlerësim i drejtë i përmbushjes ose jo të kriterit nga ana e autoritetit kontraktor. Së pari, nga veprimet dhe mos veprimet autoritetit kontraktor, KPP konstaton se shtojca e datës 25.09.2023 e cila është vënë në dijeni nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik si më sipër sqaruar, mbi të cilën kanë nisur edhe afatet proceduriale të legjitimimit (ratione temporis) të operatorit ekonomik ankimus,megjithëse nga gjurmimi në rolin e auditit të sistemit të prokurimit elektronik, rezulton se nuk është publikuar për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, duke cënuar kështu të drejtën edhe të operatorëve të tjerë ekonomikë për të patur qasje në rishikimin e vendimarrjes së autritetit kontraktor si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze për vetë faktin se kemi të bëjmë me një procedurë mbi pragun e Bashkimit Europian, por edhe mbi pragun kombëtar (kufirin e lartë monetarë), referuar nenit 11 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, autoriteti kontraktor ka detyrimin që jo vetëm të hartojë dokumentat e tenderit, por edhe t'i publikojë ato të Sistemin Elektronik të Prokurimit në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht.
Gjithashtu në rastin e ndryshimit të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka detyrimin që t'i publikojë këto ndryshime në Sistemin Elektronik të Prokurimit në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, këto ndryshime duhet të jënë në gjuhën shqipe dhe anglisht.
Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 543/25 prot, datë 11.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/3 prot, datë 12.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik u informua se më datë 25.09.2023 nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar ndryshimi i dokumentave

të tenderit sipas shkresës nr, 543/21 prot, datë 25.09.2023 "*NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT*", ndërkohë që nga verifikimet në Sistemin e Prokurimieve Elektronik të bëra nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik në rolin e audituesit të kësaj procedure konstaton se autoriteti kontraktor në datë 25.09.2023 ka ngarkuar në sistem dokumentin e emërtuar "***543.21 (1).pdf***" dhe më datë 29.09.2023 ka ngarkuar në sistem dokumentin e emërtuar "***Shtojce modifikimi mbetjet 2023 me miratim KPP vs. eng.docx***".
Gjithashtu Komisionit të Prokurimit Publik, nga verifikimet në Sistemin e Prokurimieve Elektronik konstatoi se shkresa nr, 543/21 prot, datë 25.09.2023 "*NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT*", dokumentin i emërtuar "***543.21 (1).pdf***" dhe dokumenti i emërtuar "***Shtojce modifikimi mbetjet 2023 me miratim KPP vs. eng.docx***", nuk janë publikuar në sistem dhe për rrjedhojë operatorët ekonomik vendas dhe të huaj nuk kanë marrë njoftim për ndryshimet e kritereve kualifikuese të dokumentave të tenderit të publikuara më datë 10.03.2023, duke mos respektuar hapat procedurialë të përcaktuara në bazën ligjore të sipërpërmendur.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për publikimin e dokumentave të tenderit, afati dhe detyrimi për publikimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit dhe të detyrimit për publikimin e sqarimeve për kërkesat e bëra nga ana e operatorëve ekonomik gjatë fazës së publikimit të njoftimit të kontratës, si dhe publikimi i dokumentave të tenderit, të njoftimeve për ndryshimin e tyre, të ndrryshimit të dokumentave dhe të sqarimeve për kërkesat e ofertuesve të mundshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën anglezë në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirine lartë monetar, sikurse është edhe kjo procedurë prokurimi objekt-ankimi, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.
Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor dhe konkretisht të anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe të përsonit përgjegjës për prokurimi janë bërë në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik, pasi kanë cënuar parimin e barazisë, parimin e transparencës, pasi me veprimet e tyre kanë penguar të drejtën e operatorëve ekonomik vendas dhe të huaj për t'u njohur me ndryshimet e dokumentave të tenderit, si dhe duke mos nxitur pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe duke mos nxitur konkurrencën ndërmjet këtyre të fundit.

III.1.42. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon se, autoriteti kontraktor ka patur detyrimin që të shqyrtojë ankesën e operatorëve ekonomik për ndryshimin e dokumentave të tenderit në frymën e nenit 114 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" duke vendosur pranimin, mospranimin apo pranimin e pjesshëm të pretendimeve të ankimuesit.
Referuar ankesës me nr. 2434 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3466 të operatori ekonomik "V.A.L.E RECYCLING" SHPK, Komisioini konstaton se nga ana e këtij ankimuesi ngrihen pretendime për shkelje të legjislacionit të prokurimit publik në hartimin e kriterit kualifikues lidhur me kapacitetin teknik të pajisjeve për icelerim të mbetjeve dhe për sterilizim të pajisjeve, duke kërkuar anullimin e kësaj procedure prokurimi objekt-ankimi,

ndërkohë që Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, në dispozitivin e saj ka vendosur pranimin pjesërisht të këtij pretendimi, si dhe ka rekomanduar rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Nga shqyrtimi i vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se është e pamundur që të identifikohet se cili nga pretendimet e ankimuesit është pranuar dhe se si janë pranuar këto pretendime, prandaj me shkresën nr. 2434/4 prot, datë 13.10.2023 i kërkoi autoritetit kontraktor informacion se cili/cilat nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E. Recycling" SHPK janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, ndërkohë që me shkresën nr. 2434/5 prot, datë 13.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi operatorit ekonomik ankimues "V.A.L.E Recycling" SHPK informacion nëse *me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023,* e *konsideronte të pranuar pretendimin e tij të parashtruar në ankimi elektronik me nr. A/2023/3466 dhe me nr. 2434/2023 protokolli, datë 04.10.2023, si dhe nëse i konsideron të papranuara pretendimet ju kërkua që të identifikonte pretendimin që nuk është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor, ndërkohë që këtyre kërkesave iu përgjigj vetëm autoriteti kontraktor me shkresën* nr. 543/28 prot, datë 17.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2434/6 prot, datë 18.10.2023, nga ku përsëri rezultoi e pamundur që të identifikohet pretendimi apo pretendimet që janë pranuar nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe si do të zbatohet rekomandimi për ndryshimin e dokumentave të tenderit në frymën e Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Përsa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*", si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik më datë 01.11.2023, ora 10:00, zhvilloi seancë dëgjimore më përfaqsues të njësisë së prokurimit dhe përfaqsues të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor, si dhe me përfaqsues të operatorit ekonomik ankimues, nga ku në përfundim të seancës u konstatua se përfaqsuesi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor nuk arriti të evidentonte se cilin pretendim të ankimuesit ka pranuar, si dhe nuk arriti të evidentontë se si është rekomanduar njësia e prokurimit që të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues objekt-ankimi, ndërkohë që edhe përfaqsuesi i njësisë së prokurimit të autoritetit kontraktor nuk arriti të evidentonte se si do të zbatohej rekomandimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me modifikimin e këtij kriteri kualifikues, ndërsa përfaqsuesi i operatorit ekonomik ankimues konfirmoi se është i paqartë me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe nuk arrin të evidentojë se cili pretendim i është pranuar nga ana e këtij komisioni dhe për më tepër se si do të modifikohet kriteri kualifikues objekt-ankimi.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023, nuk ka respektuar parashikimet e nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pasi nuk arrihet që të evidentohet se cila pjesë e pretendimeve të ankimuesit është pranuar dhe se si janë pranuar këto pretendime, duke e vënë Komisionin e Prokurimit Publik në pamundësi që të shprehet për këtë vendim sipas parashikimeve të nenit 115 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, lidhur me shqyrtimin nga ana e autoritetit kontraktor të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimues për dokumentat e tenderit gjatë fazës së

publikimit të njoftimit të kontratës, si dhe shqyrtimi i këtyre pretendimeve në frymën e përcaktimeve të nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Sa më sipër, KPP gjykon se , vendimarrja e autoritetit kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik është një akt administratv në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative dhe në nenin 100 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" parashikohet se: "Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. ***Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban: a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti; b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast; ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.***".

Akti administrativ për trajtimin e aneksë së autoritetit kontraktor jo vetëm që është i paqartë në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, por nuk përmban as edhe një shpjegim të ***përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave.*** Paqartësia e aktit u konfirmua në seancë dëgjimore edhe nga vetë përfaqësueist e autoritetit kontraktor njësisë së prokurimit. Kjo paqartësi e trajtimit të aneksës ka sjellë disa pasoja juridike të cilat nuk mund të rregullohen me një vendimarrje të ardhshme të Komisionit të Prokurimit Publik si pa mundësinë e autoritetit kontaktor për të hartuar një shtojcë mbi dokumentet e tenderit dhe vendosur në dispozicion të operatorëve ekonomikë, pamundësinë e operatorit ekonomik për të paraqitur arguemente kundërshtuese mbi vendimarrjen e autoritetit kontraktor por edhe pa mundësinë e Komisionit të Prokurimit Publik për të gjykuar mbi pjesën e pranuar të autoritetit kontraktor dhe kryer veprimet proceduriale mbështetur në ligj.

Së fundmi, KPP vlerëson se në respekt të nenit 77 të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: "*autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.".

Gjithashtu, referuar proces verbalit të argumentimit të kritereve dhe të specifikimeve teknike të publikuar sëbashku me procedurën e prokurimit (para ndryshimeve të kritereve bazuar në

vendimarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik) autoriteti kontraktor, në kriterin mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe paisjeve ndër të tjera ka argumentuar si më poshtë vijon:
*"**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, "Për miratimin e rregullores, 'Për administrimin e mbetjeve spitalore'", VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", impiantet për realizimin e trajtimit te kategorive te caktuara te mbetjeve spitalore, jane pajisjet baze per realizimin me sukses te ketij sherbimi. Gjithashtu, AK, ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, ka parashikuar që në dallim nga kontenitoret per te mprehtat dhe qeset, që janë amballazhi i drejtpërdrejtë i mbetjeve spitalore që duhet të jenë njëpërdorimëshe, kontenitoret plastike te medhenj qe duhet te vihen ne dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues që shërbejnë për transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet te jene shumeperdorimesh dhe kjo nuk eshte nje zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore sic percaktohet nga neni 6 i Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, neni 7 dhe neni 33 i Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, si dhe në Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM nr. 798, datë 29.09.2010, "Për miratimin e rregullores, 'Për administrimin e mbetjeve spitalore'". Pra, AK ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, duke kerkuar konteniere plastike të mëdhenj që mund të ripërdoren, ka zbatuar pikërisht parimin e "minimizimit të prodhimit të mbetjeve", pasi nëse do të pranonte konteniere njëpërdorimësh që duhet të asgjesohen pas cdo përdorimi së bashku me mbetjet spitalore, do të shumëfishonte volumin e mbetjeve që shkojnë për asgjesim dhe kjo do të ishtë në kundershtim me të gjitha parimet e sipërcituara. Per kete arsye, per kontenieret e medhenj që janë shumëpërdorimesh eshte e nevojshme te garantohet që OE disponon pajisjet dhe lejet e nevojshme për larjen dhe higjienizimin e tyre me qëllim ripërdorimi.

Për të përllogaritur kapacitetet minimale të kërkuara, për secilin impiant, është marrë për bazë sasia totale e parashikuar për gjithë periudhën, e përllogaritur në sasi mesatare ditore duke prezumuar punë të pandërprerë të impianteve për 365 ditë në vit dhe më tej është përllogaritur kapaciteti orar, duke prezumuar impiantet në gjendje pune për 16 ore (dy turne).

Grupet sipas metodes se trajtimit	*Sasi 36 muaj në kg*	*Sasi 12 muaj në kg*	*Sasi ditore në kg*	*Sasi në kg/ore*
Asgjesim me incenerim (18 01 02 (pjesë të trupit dhe organe); 18 01 06; 18 01 07; 18 01 08; 18 01 09)	*190,177.00*	*63,392.00*	*173.00*	*11.00*
Trajtim me metoda te ndryshme nga incenerimi (18 01 01; 18 01 02 (përvec pjesë të trupit dhe organe); 18 01 03; 18 01 04)	*1,970,115.00*	*656,705.00*	*1,799.00*	*112.00*

Duke mbajtur në konsideratë, se impiantet do jene në gjendje pune të vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohet edhe një makineri back up, për secilin impiant me të njejtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licensat përkatëse, cka sërish do të shkaktonte ndërprerje me muaj të shërbimit.

Lejet e kerkuara per objektin/et e dhene/a me qera vertetojne se keto pajisje jane te licensuara per realizimin e procesit te trajtimit te mbetjeve nga organi kompetent. Ky ceritfikim eshte detyrim ligjor per te gjitha pajisjet te cilat kryejne keto lloj procesesh ne territorin e RSH dhe jo per pronarin apo personin e trete ndaj kerkesa eshte e domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit ne fjale. Fokusi i kesaj kerkese eshte tek impianti dhe jo tek personat e trete te cilet japin me qera apo huaperdorje.
Duke qene nje procedure e perqendruar me kerkesa nga te gjitha spitalet publike, ky sherbim do te jete i vazhdueshem dhe me dinamika te ndryshme ne rang territori kombetar. Kerkesat per marrjen e mbetjeve ditore nuk mund te percaktohen paraprakisht pasi dhe vete spitalet nuk mund te parashikojne gjenerimet ne baze ditore cka do te bente nje calendar te sakte per OE. Afatet kohore per grumbullimin e mbetjeve jane taksative nga pikepamja ligjore dhe te ndryshme sa i takon rrymave te tyre. Rrjedhimisht kjo gje kerkon me patjeter nga OE grumbullimin e mbetjeve sipas kerkesave te AK ve ne kohe te ndryshme cka e ben kete sherbim te vazhdueshem dhe te paparashikueshem. Nje system reserve back up do te garantonte vazhdueshmerine e sherbimit ne rast defektesh, mirembajtjesh, apo raste te forces madhore (mbi ngarkese ne sasite) etj.".

Pra, autoriteti kontraktor ka vlerësuar se vendosja e Kapacitetit të mjeteve dhe paisjeve është vënë në përputhje me volumin e kontratës, ndërkohë po autoriteti kontraktor përmes vendimarrjes së Komisionit të Shqyrtimti të Ankesave pranon se ky kapacitet duhet të ndryshojë më qëllim rritjen e konkurencës në frymën e ligjit të prokurimit publik, duke mos qenë në thelbi qartë mbi mënyrën e ndryshimit, kapacitetet përpunuese të mjeteve dhe paisjeve.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor dhe konkretisht të anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave janë bërë në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik, pasi nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", duke cënuar parimin e barazisë, parimin e transparencës, si dhe me veprimet e tyre anëtarët Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave e kanë penguar të drejtën e operatorëve ekonomik ankimues për të paraqitur argumenta shtesë lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave sipas parashikimeve të nenit 42, pika 5 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*".
Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor dhe konkretisht të anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave kanë vendosur Komisionin e Prokurimit Publik në pamundësi për të zbatuar parashikimet e nenit 115 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

III.1.43. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publik dhe në rastin e vendimmarrjes se Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesit për modifikimin e dokumentave të tenderit anëtarët e njësisë së prokurimit kanë detyrimin ligjor që të modifikojnë këto dokumenta duke hartuar dhe publikuar një shtojcë sipas përcaktimeve të vendimit të Komisionit të Shqyrtimitt ë Ankesave.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se me vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në dispozitivin e saj ka vendosur pranimin pjesërisht të këtij pretendimi, si dhe ka rekomanduar rishikimin e kriterit të vendosur në DST (kapacitetet teknike), në frymën e zbatimit të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ndërkohë që njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për zbatimin e këtij vendimi.

Përsa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*", si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik më datë 01.11.2023, ora 10:00, zhvilloi seancë dëgjimore më përfaqsues të njësisë së prokurimit dhe përfaqsues të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor, si dhe me përfaqsues të operatorit ekonomik ankimues, nga ku në përfundim të seancës u konstatua se ndonëse vendimin nr. 543/24 prot, datë 10.10.2023 i Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka problematikat e tij referuar pikës III.1.42 të këtij vendimi, njësia e prokurimit nuk ka njohuritë e duhura teknike lidhur me hartimin e kriterit kualifikues objekt-ankimi, duke mos arritur dot që të modifikojë këtë kriter kualifikues, duke mos respektuar hapat procedurialë të përcaktuara në bazën ligjore të sipërpërmendur.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për publikimin e dokumentave të tenderit, afati dhe detyrimi për publikimin e ndryshimeve të dokumentave të tenderit dhe të detyrimit për publikimin e sqarimeve për kërkesat e bëra nga ana e operatorëve ekonomik gjatë fazës së publikimit të njoftimit të kontratës, si dhe publikimi i dokumentave të tenderit, të njoftimeve për ndryshimin e tyre, të ndrryshimit të dokumentave dhe të sqarimeve për kërkesat e ofertuesve të mundshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën anglezë në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirine lartë monetar, sikurse është edhe kjo procedurë prokurimi objekt-ankimi, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor dhe konkretisht të anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe të përsonit përgjegjës për prokurimi janë bërë në kundërshtim me parimet dhe rregullat e prokurimit publik, pasi kanë cënuar parimin e barazisë, parimin e transparencës, pasi me veprimet e tyre kanë penguar të drejtën e operatorëve ekonomik vendas dhe të huaj për t'u njohur me ndryshimet e dokumentave të tenderit, si dhe duke mos nxitur pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe duke mos nxitur konkurrencën ndërmjet këtyre të fundit.

III.1.44. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin”, nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[…] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” […]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i hartimit dhe publikimit të modifikimeve të dokumentave të tenderit nga ana e anëtarëve të njësisë së prokurimit, shqyrtimi i ankesës nga ana e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për modifikimin e këtyre dokumentave dhe mosveprimet e njësisë së prokurimit për zbatimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik për shkaqet e sipërcituara, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se veprimet proceduriale të sipërpërmendura janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e tyre. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar, kriteret për kualifikim, në përputhje me nevojat dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik. Në kushtet kur autoriteti kontraktues ka ndërmarrë hapa procedurialë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet.

III.1.45. Në lidhje me konstatimet e mësipërme, Komisioni i Prokurimit gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e hetimit administrativ bazuar në nenin 23 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, për sa kohë se procesi i hartimit dhe publikimit të modifikimeve të dokumentave të tenderit nga ana e anëtarëve të njësisë së prokurimit, shqyrtimi i ankesës nga ana e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për modifikimin e këtyre dokumentave dhe mosveprimet e njësisë së prokurimit për zbatimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik për shkaqet e sipërcituara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”,”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19" Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*", me Nr. *REF-61901-03-09-2023*, me objekt "*Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, për mbulimin e nevojave spitalore për një periudhë 36 mujore" - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj*" me fond limit të marrëveshjes kuadër 785,788,138 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, ose 6,868,777 Euro pa TVSH sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 09.03.2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 24.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet në arsyetimin e vendimit të mësipërm dhe ti dërgohet kopje e akteve të dosjes objekt shqyrtimit

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*V.A.L.E. RECYCLING*" SHPK.

6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar **Fiorent Zguro**	**Anëtar** **Anila Malaj**	**Anëtar** **Kreshnik Ternova**

Kryetar
Jonaid Myzyri

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2023.11.21
04:56:43

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2023/11/21 15:47:51 +02'00'
840364202311211547443902 0

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)